

UNITED
NATIONS

United Nations UNMIK
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES

Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPTI
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 20, 22 DHE 23.12. 2006

TRANSKRIPT
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE DANA 20, 22 I 23.12.2006. GOD.

DHJETOR – DECEMBAR 2006

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2007,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 2003/4 për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë,
9. Shqyrtimi i propozimvendimit për ridestinimin e mjeteve të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale

DNEVNI RED

1. Potvrdivanje dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona o budžetu Kosova za 2007. godinu,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti bilja,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o podsticanju zaštite i promovisanja dojenja,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o sprečavanju i suzbijanju zaraznih bolesti,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 2002/9 o Inspekciji rada,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 2003/4 o likvidaciji i reorganizaciji pravnih lica,
9. Razmatranje predloga Odluke o utvrđivanju namene sredstava Ministarstva za rad i socijalna pitanja.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Mirë mëngjesi dhe mirë se keni ardhur. Kërkoj 15 minuta pauzë, në të vërtetë ta shtyj mbledhjen për 15 minuta deri sa të bisedoj me kryetarët e grupeve parlamentare. Kërkoj mirëkuptim për këtë.

Lus deputetët që t'i zënë vendet e tyre.

Të nderuar deputetë, i nderuar kryeministër dhe ministra të kabinetit qeveritar. Mirë se keni ardhur në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës. Ju njoftojë se në sallë aktualisht janë 83 deputetë, që do të thotë se ekziston mundësia që të fillojmë me punë, andaj propozoj të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës ,siç e keni marrë materialin, është konfirmimi i rendit të ditës. Në pajtim me rregullat 6 dhe 23 të Rregullores së punës, Kryesia e Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme plenare, sipas ftesës që u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Meqë Kryesia nuk ka marrë asnjë propozim tjetër me shkrim për plotësimin e rendit të ditës, atëherë në pajtim me rregullen e re 23.2 konstatoj se rendi i ditës është miratuar.

Pika e tretë e rendit të ditës është: koha e pyetjeve.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 26.1 të Rregullores së punës të Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta gjithsej. Me afat të caktuar me Rregullore janë tri pyetje parlamentare për të cilat nuk është dhënë përgjigje në seancën e kaluar, Fillojmë me këto pyetje, Deputeti Xhevat Bislimi nga PDK-ja ka pyetje për kryeministrin e Kosovës z. Agim Çekun. Deputeti mungon, prandaj shtyhet edhe pyetjen e dytë e ka kështu i njëjti deputet. Shkojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, deputeti Ferid Agani ka pyetje për kryeministrin e Kosovës z. Agim Çekun. Z. Agani doni ta përsëritni pyetjen. Urdhëroni.

DEPUTETI FERID AGANI – I nderuari z. kryeministër, zbatimi i ligjshmërisë është themeli i funksionimit të çdo shteti demokratik. Me vendimin tuaj 04/219 të datës 10 tetor 2006 ju keni shkelur nenin 49 të Ligjit për shëndetësi të Kosovës, që siguron që institucioni shëndetësor të udhëhiqet nga drejtori, pika 49.1,dhe se mënyra e zgjedhjes , e shkarkimit dhe mandati i drejtorit të institucionit shëndetësor përcaktohen në pajtim me rregullativën ligjore për shërbimin civil pika 49.2. në pikën 3 të vendimit tuaj duke e ngarkuar Ministrinë e Shëndetësisë që ta hartojë udhëzimin administrativ për themelimin e bordit ekzekutiv të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe t’ia paraqesë Qeverisë për miratim. Ju në mënyrë të qartë e keni shkelur ligjshmërinë në këtë aspekt. Udhëzimi administrativ për shëndetësi 16/2006, i nxjerrë në bazë të kërkesës suaj në të gjitha nenet e tij paraqet shkelje të dispozitave përkatëse të Ligjit për shëndetësi dhe të Rregullores 2001/36 për shërbyesit civilë.

Pyetja është z. kryeministër: A e shihni se ekziston përgjegjësi personale në politikën tuaj dhe të ministrit të Shëndetësisë lidhur me këtë shkelje të ligjshmërisë dhe çka do të ndërmerri apo keni ndërmarrë lidhur me këtë? Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA Ju faleminderit. Urdhëroni z. kryeministër

KRYEMINISTRI AGIM -ÇEKU –I nderuar z. kryetar, të nderuar deputetë, ministra dhe z. Agani.

Ashtu si thatë edhe ju, ndërtimi i një shteti të fortë ligjor çfarë po synon Kosova është parim mbi të cilin funksionon Qeveria e Kosovës. Vendimet tona merren gjithmonë konform normave ligjore në konsultim me ekspertët e fushave përkatëse dhe në pajtim me politikat e Qeverisë. Mbi këto baza është marrë edhe vendimi për emërimin e bordit të përkohshëm ekzekutiv të QKU-së. Nenet 49.1 dhe 49.2 në Ligjin për shëndetësi ,të cilit ju po i referoheni thotë se: instucionin shëndetësor e udhëheq, drejtori dhe se

mënyra e zgjedhjes .e shkarkimit dhe mandati i drejtorit të institucionit shëndetësor sigurohen në pajtim me rregullativën ligjore për shërbimin civil.

Drejtori mëparshëm i QKU-së ka qenë i zgjedhur sipas kësaj rregullative dhe është shkarkuar sipas saj(i referohem neneve 30 1/b dhe 30.2 të Rregullores për shërbimin civil 2001/31) e fuqizuar me urdhëresë administrative 2003/2, e lëshuar nga UNMIK-u. Ju e dini se grupi ndërministror për shëndetësi në shtator ka emëruar një grup ekspertësh për të bërë vlerësimin e situatës reale në QKU dhe për të dhënë rekomandime për dalje nga kriza. Ky grup i përbërë edhe nga vetë ekspertët e QKU-së ka konkluduar se QKU-ja nuk është menaxhuar si duhet. Një nga rekomandimet për t'u implementuar më shpejt ka qenë krijimi i një bordi të përkohshëm ekzekutiv.

Ky bord do të bëjë sanimin e gjendjes së rëndë dhe do të krijojë kushte minimale që duhet t'i paraprijnë emërimeve të reja në postet udhëheqëse të QKUK-së. Këtë rekomandim unë dhe Qeveria që drejtoj e kemi aprovuar unanimisht. Rreferuar neneve 31 dhe 50 të Ligjit për shëndetësi, bordi i përkohshëm obligohet të krijojë statutin për QKUK-në, pas aprovimit të të cilit do të bëhet shpallja e konkurseve dhe emërimi i drejtorëve përkatës sipas ligjeve në fuqi, pra bordi është formuar si një urë lidhëse në mes të krijimit të kushteve për të dalë nga kriza në QKUK dhe konsolidimit të një situate të qëndrueshme që do të mundësojë implementimin e statutit pasi ai të jetë i aprovuar.

Qeveria është e kënaqur me punën e bordit që ka arritur ta bëjë në këtë afat të shkurtër dhe mbështet plotësisht çdo iniciativë të tij që ka për qëllim përmirësimin e kushteve të punës dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në këtë institucion shumë të rëndësishëm.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! z. ministër, deputeti Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryeministër, mendoj se në përgjigjen tuaj praktikisht e keni legjitimuar edhe një herë vendimin të cilin e keni marrë. Unë i kuptoj dëshirën dhe qëllimet e mira dhe i përshëndes edhe rezultatet e arritura në konsolidimin e gjendjes në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, por nuk është fjala e parë për çështjen e kuadrove konkrete, por është fjala për atë për një parim. N ë qoftë se këtë gjendje të vështirë dëshirojmë ta zgjidhim me mjete të cilat nuk janë në pajtim me ligjin, a mos po hyjmë kështu në një anarki, në një sjellje voluntere të individëve ose të grupeve të cilat kanë vetëm mbështetje politike .por nuk kanë mbështetje ligjore? .Pra, unë nuk shoh arsye pse nuk çelet konkursi për emërimin e drejtorit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në këtë mënyrë të vihet rendi në këtë qendër.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Meqë nuk ka përgjigje tjetër, kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2007.

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 30 nëntor 2006 në pajtim me rregullën 35.10. Komisioni për Buxhet dhe Financa, është komision i vetëm që mund t'i rekomandojë Kuvendit në lidhje me buxhetin, andaj vazhdojmë me shqyrtimin e amendamenteve një nga një sipas radhës, por së pari për fjalë është paraqitur kryetari i Komisionit për Buxhet z. Naser Osmani.

DEPUTETI NASER OSMANI – Ju faleminderit i nderuari kryetar, i nderuar kryeministër, të nderuar ministra dhe deputetë.

Meqenëse jemi në fazën e amendamentimit të Projektligjit kam për obligim t'i them disa fjalë lidhur me procedurat dhe me punën që e ka bërë Komisioni për të arritur në këtë moment. Po na përsëritet prej vitit në vit, që buxheti të vijë në Kuvend pak i vonuar, edhe nga pak prej presionit të UNMIK-ut që të aprovohet buxheti para kërshëndellave dhe kjo komisionin po e qet në situata të palakmueshme.

Komisioni nuk ka potencial që me e përballuar një punë kaq voluminoze në mungesë të ekspertëve, sidomos të analistëve buxhetorë dhe në mungesë të ekspertëve që kishin me e mbështetur Komisionin për punën e tij, qoftë për buxhet, qoftë për të gjitha ligjet që kanë të bëjnë ku Komisioni për Buxhet është komisioni funksional.

Ne jemi munduar të bëjmë një zgjidhje për vitin e ardhshëm fiskal që Kuvendi ta ketë një zyre ligjore ,ku do të kemi 7 ekspertë dhe presim që së paku dy prej tyre të jenë në mbështetje të Komisionit për Buxhet dhe Financa, po ashtu po na qet vështirësi të madhe mosunifikimi i ligjeve që kanë të bëjnë me rregullimin e infrastrukturës ligjore për dispozitat financiare për zyre dhe agjensionet e rregullatorëve të pavarur që thjeshtë janë organet e Kuvendit ku Kuvendi duhet t'i aprovojë buxhetet e tyre.

Mirëpo, fjala ime është diku krejt tjetër. Unë e kam marrë fjalën sot këtu që t'i falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit, të gjitha partive politike që bëjnë pjesë në komision, për punën dhe zellin që kanë treguar në dy javët e fundit që kanë mbajtur jo ma pak 23 mbledhje për me u draftue ky ligj që është sot para juve, po në këto dy javë kemi draftue edhe Ligjin për prokurimin publik dhe Ligjin për raportime financiare, për dy javë Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur 30 takime dhe unë si kryetar i këtij komisioni kam obligim me i falënderuar të gjithë anëtarët e tij që nuk kanë kursyer asnjë moment të japim kontributin e tyre. Mirëpo edhe në fund duke respektuar mendimin e tyre politik për votimin e fundit, kërkoj në emër të Komisionit që deputetët sot të mbështesin ligjin në fjalë edhe draftin e përpunuar dhe të amendamentuar, por edhe buxhetet e zyrave dhe të agjensioneve të pavarura të Kuvendit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Unë nuk e di që është përmendur emri i juaj. Urdhëroni z. Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Puna e parë, shumë gjëra që tha kryetari i Komisionit janë të vërteta ,qëndrojnë. Komisioni ka punuar intensivisht ka punuar shumë edhe është munduar konform përgjegjësive të veta me i krye obligimet që i ka, mirëpo rekomandimi

që u dëgjua nga goja e kryetarit të Komisionit nuk është i vërtetë. Komisioni jo me anonimitet nuk ka kërkuar që të përkrahet dhe të mbështetet ky buxhet, prandaj duhet të sqarohemi, pra në Komision të Buxhetit është votuar edhe ka fituar ky draft propozim, 4 me tre apo 5 me katër, prandaj nuk ka qenë pozicion unanim i Komisionit që të përkrahet buxheti. Tta kem të qartë, sepse opozita ka votuar kundër, ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Jakup Krasniqi e ka fjalën.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Komisionet le ta marrin fjalën.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Safete Hadergjonaj,

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – Unë dëgjova me kujdes fjalën e kryetarit të Komisionit, nuk dua ta mohoj punën e kryetarit të Komisionit, megjithatë puna në komision nuk ka qenë edhe aq efektive si e paraqiti kryetari i Komisionit, meqenëse ne kemi bërë disa dëgjime buxhetore që kanë qenë krejt formale dhe kryetari i Komisionit e di që shumicën e dëgjimeve buxhetore e kemi bërë dy apo tre anëtarë, apo një anëtar vetëm, kështu që ne jemi përpjekur të japim kontributin tonë ,mirëpo puna në komision nuk ka qenë aq efektive, siç e paraqiti kryetari i Komisionit.

Anëtarët e opozitës kanë marrë pjesë në diskutim dhe në mbledhjen e Komisionit dhe nuk janë pajtuar me ndryshimet dhe amendamentimet të cilat i janë bërë buxhetit. Ne fakt nuk jemi pajtuar fare me këtë buxhet dhe në komision në vota të anëtarëve të Komisionit, të cilët janë nga radhët e opozitës, kanë qenë vota kundër këtij projektbuxheti.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi

DEPUTETI IBUSH JONUZI- Ju faleminderit i nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj. Më lejoni që shkurt në emër të Komisionit parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri Energjetikë dhe Miniera. Transport dhe Telekomunikacion të shprehim mendime dhe qëndrime lidhur me buxhetin e vitit 2007, të vetëdijshëm se nevojat apo kërkesat janë shumë më të mëdha se mundësitë, komisioni ka dalë me propozim që të bëhet gjithçka që është e mundur që në vitin 2007 Trepça të shpëtohet nga shkatërrimi dhe pastaj në vazhdimësi të krijohen kushtet favorizuese për punën e saj. Mjetet e ndara nuk mjaftojnë që ajo të ruhet e as të fillojë prodhimin për ta mbajtur vetveten dhe për të ndihmuar buxhetin e Kosovës, ndërsa ne kërkojmë që gjithsesi të investohet për ta kthyer në jetë gjigantin e dikurshëm, prodhimi i të cilit do t'i kontribuojë zhvillimit ekonomik, mirëqenie shoqërore dhe stabilitetit politik. Në vitet 90-99 Trepça vetëm është shfrytëzuar, ndërsa nuk është investuar në të, prandaj janë disa projekte pa të cilat nuk mund të funksionojë procesi i prodhimit, domethënë nuk mund të ketë prodhim pa përgatitjen e objekteve të tjera që ato janë funksionale. Prej shumës së përgjithshme të mjeteve të ndara deri tani nga buxheti i konsoliduar i Kosovës vetëm 13 milion 988 mijë e 491 euro janë mjete të

dedikuara dhe të shpenzuara për përgatitjen e minierave për prodhim, kurse të gjitha mjetet e tjera janë shpenzuar për ruajtjen e objekteve dhe për çështje sociale.

Projektet, të cilat planifikohen të realizohen brenda vitit 2007 lidhur me përgatitjen e prodhimit në Trepçë janë:

1. Riparimi i pusit qorr dhe zëvendësimi i kompresorit statik me kompresor mobil në minierën e Stari Trgut,
2. Ruajtja e minierës së Artanës nga fundosja dhe aftësimi për prodhim dhe eksploatim në nivelin 680 horizonti 7.
3. Riparimi i flotacionit dhe s'lerosja e lënies së formimit të flotacionit tuneli i parë,
4. Rehabilitimi i minierës së Ajvalisë,
5. Riparimi i flotacionit dhe shpëlorosja e linjës së thërmit në flotacionin e Kishnicës.
6. Instalimi i pajisjeve automatike për reagencën në flotacionin e Leposaviqit dhe
7. Rehabilitimi i minierës së Belo Brdës për prodhim.

Shuma e përgjithshme e mjeteve për investim në këto projekteve është 4 milion e 485 mijë euro. Prej këtyre në vitin 2007 janë planifikuar të ndahen 2 milion e 845 mijë euro që do të thotë se për këto projekte nevojiten edhe 1 milion e 640 mijë euro, nëse nuk llogariten në projektin nën pikën rendore 7 që kap shumën prej 750 euro, megjithatë ne mbështesim Projektbuxhetin e propozuar nga Ministria. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Z. Krasniqi, së pari e kanë radhën shefat e grupeve parlamentare.

Urdhëroni z. Xhemajli.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Ju faleminderit z. kryetar përshëndetje për gjithë. Unë pajtohem me të gjitha ato që i tha kryetari i Komisionit, po dua të shtoj edhe diçk. Kam tërhequr me kohë vërejtjen se tendencat për t'ia vënë drynin Trepçës janë shumë të theksuara dhe edhe ky buxhet mendoj se tregon një tendencë të tillë. Mua më shqetëson fakti se edhe dua të pyes ministrin e Ekonomisë dhe të Financave a mos është pjesë e këtij skenari edhe kjo ministri, sipas ndarjes së këtij buxheti Po për shkak që të mos të jepen 300 mijë euro për ta shpëtuar një minierë që është më e pasura në Evropë me metal 36% xeheror, kjo nuk mund të komentohet ndryshe dhe qoftë edhe vetëm për këtë çështje, vetëm për këtë ndarje që nuk i bëhet Trepçës. Unë mendoj që nuk duhet të votohet ky projektbuxhet nga asnjë deputet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI –Z. kryetar, i nderuari kryeministër .të nderuar deputetë, Për Projektbuxhetin që do të duhej ta miratonim sot, Grupi Parlamentar në seancën kur është bërë leximi i parë këtij projektligji apo projektbuxheti , në mënyrë analitike i ka treguar të gjitha dobësitë e këtij projektbuxheti të vitit 2007. Ne vetëm mund të

përsërisim se Projektbuxheti për vitin 2006 nuk ka ofruar asnjë politikë programore e cila do të na obligonte që ta votojmë këtë projektligj. Nuk ka analiza makro ekonomike, nuk ka projekte sidomos kur është fjala për pjesën kapitale, nuk ka ndarje të buxhetit sipas meritës sidomos për kategoritë sociale e në mënyrë të veçantë për kategoritë e luftës çlirimtare. Pastaj ne gjatë gjithë vitit ose ma mirë me thanë gjatë dy viteve të shkuara e kemi ngritur çështjen e shkeljeve të ligjeve nga Qeveria dhe gjithë kabineti qeveritar, kryeministri dhe Qeveria nuk ka marrë asnjë masë ndaj shkelësve të ligjit dhe keqpërdoruesve të buxhetit. Kemi argumentuar keqpërdorimet e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe dikush është dashur për këto keqpërdorime të japë edhe përgjegjësi penale. Kjo nuk ka ndodhur as përgjegjësia morale, e nuk ka ndodhur as përgjegjësia politike.

Kemi kërkuar vazhdimisht të formohen komisionet e kontrollit për të kontrolluar shfrytëzimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe ky Parlament në asnjë rast nuk ka qenë i gatshëm për të formuar komisione të kontrollit për ta kontrolluar shfrytëzimin e buxhetit nga shfrytëzuesit e tij. Ne konsiderojmë se buxheti, kështu si na është ofruar, është buxhet i varfërisë, i padijes dhe i mjerimit të skajshëm, për fatkeqësi edhe kategoritë që jetojnë në varfëri të skajshme nuk përfitojnë asgjë ky buxhet. Ne, Grupi Parlamentar i PDK-së nuk do të marrim pjesë në votonin e këtij projektbuxheti, bile as nuk do të marrim pjesë në asnjë formë të votimit, por kisha kërkuar që të gjithë ata që janë të bindur se ky buxhet është i mjerimit, i padijes, i varfërisë, buxhet që vetëm do t'u jepte mundësi keqpërdoruesve të tij ta shfrytëzojnë për interesa private, të mos marrim pjesë as në votim bile edhe ta lëshojnë seancën e Parlamentit. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Alush Gashi e ka fjalën.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit, Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar projektbuxhetin me shumë kujdes dhe atë disa herë. Kemi pasur shumë dëgjime buxhetore janë bërë përpjekje maksimale që të plotësohen kërkesat por mundësitë buxhetore janë këto që janë. Ne jemi të vetëdijshëm që ky buxhet nuk i plotëson as për afërsisht nevojat e qytetarëve të Kosovës në këtë fazë të zhvillimit dhe ripërsëris atë që kemi ardhur në përfundim që në dëgjimin e Grupit Parlamentar të LDK-së se mundësitë reale janë këto që janë dhe si grup parlamentar ne e mbështesim buxhetin dhe i ftojme edhe grupet e tjera që të japin kontributin e vet në përmirësim të këtij buxhetit në faza të tjera. Kërkojmë nga Qeveria që me përpikëri t'i zbatojë vendimet e Kuvendit dhe në fazat e mëvonshme dhe të bëjë rishqyrtimin e tij.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA KOLLQAKU - Unë kam dashur në emër të komisionit funksional po paraprkishtë ndoshta ka përparësi shefja e grupit parlamentar, unë në emër të komisionit funksional, tash respektojeni një parim,

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit fjalën e ka Gjylnaze Syla

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA - Ju faleminderit z. kryetar. Grupi Parlamentar i Aleancës me shumë kujdes dhe me shumë përpikëri e ka përcjellë çdo linjë buxhetore, ne i kemi thënë edhe në shqyrtimin e parë se buxheti nuk mundet me i plotësuar të gjitha nevojat, por vihen prioritetet, dhe kemi shqyrtuar edhe këto prioritete, prandaj mendojmë se sot duke marrë parasysh edhe amendmanet e Komisionit për Buxhet dhe Financa që të votohet buxheti. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqiu.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIU – ju faleminderit z. kryetar në bazë të diskutimeve të cilat i dëgjuam gjatë kësaj dite në lidhje me pikën e buxhetit është më se evidente që nuk ekziston një unitet edhe një konsensus as në Komisionin për Buxhet as në Komisionin për Ekonomi, as në mendimet e ndryshme të cilat i shprehën deputetët.

Këtu shihet, përveç kësaj, se edhe rekomandimet të cilat kanë ardhur siç e kuptuam pa ndonjë konsensus kanë ardhur edhe me kohë jashtëzakonisht vonë sikur edhe buxheti se ka qenë një kohë shumë e shkurtër për të pasur kohë për t'i analizuar dhe për të marrë parasysh të gjitha këto. Shihet që për këtë buxhet ka pasur mosrespektim të prioriteteve. Prioritetet, siç u cek më përpara, nuk kanë qenë prioritete, po kanë qenë të lëna anash dhe jo të përfshira në këtë buxhet, të mos i cekim të gjitha që u cekën por gjithashtu edhe tekstet shkollorë pensionistët e të gjithë ata të cilët edhe gjatë këtij buxheti anashkalohen dhe nuk merren si prioritet, Prej kësaj del një përfundim që ky buxhet kërkon edhe një debat, edhe ndoshta po pa ndoshta, një rishqyrtim një analizë edhe një herë dhe ripërcaktimin e prioriteteve dhe si i tillë është i vështirë të votohet prej grupit parlamentar. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha- Kollçaku.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU – Ju faleminderit z. kryetar në emër të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale jam i autorizuar t'i ngrit disa çështje lidhur me buxhetin. Së pari vërejtja, si u cek edhe më parë, amendamentet e Komisionit të Buxhetit kanë ardhur para dy ditëve, do të thotë nuk e kanë plotësuar atë afatin kohë prej pesë ditësh minimum për me pas kohë me analizua dhe ne si komision funksional faktikisht nuk kemi pas kohë për me ndërhyrë ndryshe përveç me i theksuar disa çështje këtu. Së pari sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë, është e qartë që është një dukuri që investohet në disa projekte të cilave faktikisht u prolongohet jetësimi me një parashikim jo të mençur dhe me një alokim të mjeteve jo aty ku duhet. P.sh. vetëm Shtëpinë Integruese Shtimje, Qendrën Kombëtare Ortoprotetike, furnizimin me banderola që është obligim ligjor dhe rekomandimi i auditorit, programi për shërim jashtë vendit, si dhe projektet që nuk do të jetësohen këtë vit dhe rrezikojnë të mbyllën, siç janë: Instituti i Onkologjisë, Klinika e Kardiokirurgjisë, kabineti i kardiologjisë invazive, fjala është këtu se vazhdimisht po investohet. Investimet kapitale po shkojnë në projekte të reja, ndërsa nuk po i parashikojnë të përfundojnë projektet e

filluara dhe më në fund po e marr një shembull. Një qytetar i Kosovës, bile një angiokardiografi ta kryejë në Kosovë dhe jo të ketë nevojë vazhdimisht në Turqi dhe në vende të tjera.

Çështja e dytë është që e kemi sa i përket Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural janë mjetet e alokuara për Agjensionin Veterinar dhe Ushqimit të Kosovës, një agjension që aktualisht nuk ekziston së paku nuk e ka këtë emër, ky është shërbim dhe ky kuvend duhet ta votojë një ligj dhe ligjin për ushqim . Dëshirojmë një sqarim për këtë term dhe mjetet që janë alukuar këtu, se është shumë e njohur që nuk është votuar ky ligj në Kuvendin e Kosovës.

Çështja e tretë janë ligjet pa mbulesë financiare që në vazhdimësi po procedohen në këtë Kuvend dhe një numër shumë i madh është proceduar në Komisionin funksional për Shëndetësi ,Punë dhe Mirëqenie. Ne e kemi obligim edhe para votuesve, sepse është bllokuar .Shumë herë është përmendur Ligji për sigurim shëndetësor, tani dy vjet nuk është jetësuar Ligji për pensione që ka qenë obligim për sigurim pensional dhe invalidor qysh para një viti e gjysmë me procedurë të përsheptuar të silltet në Kuvend është mohuar e drejta. Këtë po e them në emër timin personal, një drejtë e pakontensueshme dhe e pamohueshme, është pensioni i siguruar me punë ,domethënë nuk po shohim që po parashihet ajo. Kështu këto janë disa çështje që tregojnë se buxheti me të vërtetë nuk është përcaktuar në bazë të prioriteteteve, por në vazhdimësi po investohet në projekte të reja ,ndërsa nuk po parashihet jetësimi i projekteve që një herë kanë filluar. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni. Urdhëroni z. Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar po flas në cilësinë e udhëheqësit të Grupit Parlamentar për Integrim që i shqyrtoi rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa edhe pse siç tha edhe parafolësja brenda një afati shumë të shkurtër kohor, rekomandimet nuk i adresojnë të gjitha brengat tona të cilat i kemi ngritë edhe në seancën plenare në dëgjimin e parë të këtij projektligji, për të mos u përsëritur me parafolësit. Unë mendoj se ky projektligj në këtë seancë duhet të refuzohet dhe të shkojë në dëgjim të tretë. Mendojmë se kemi të bëjmë me dokumentin më të rëndësishëm ligjor që Kuvendi i Kosovës mund ta miratojë .ndonëse me kompetenca të kufizuara..Vetëm një shembull eklatant që e përmendi edhe parafolësja të ndahen për investime kapitale në sektorin e shëndetësisë rreth 9 milionë euro e ndërkohë të mos jemi në gjendje t'i aktivizojmë ato objekte të cilat i kemi ndërtuar me investime kapitale në vitin 2006, do të thotë ne po ndërtojmë vetëm objekte e ato po mbesin të paaktivizuara. Çfarë logjike është kjo,, çfarë buxheti është ky. në funksion të kujt është ky buxhet, a bëhet ky buxhet për dëshirë të autoriteteve vendore ose të huaja ,që kanë interesa krejtësisht të tjera prej interesave të qytetarëve apo bëhet për interes të qytetarëve të Kosovës.

Të investohen 9 milion euro në objekte kapitale në vitin 2007, ndërsa të ngelë pa aktivizuar Instituti i Onkologjisë dhe i Kardiokirurgjisë Diagnostike Invazive, mendoj se

është absurd. Prandaj, krahas atyre që u përmenden edhe rasti i Trepçës edhe shumë shembuj të tjerë është e qartë se planifikimi i këtij buxheti nuk është bërë në pajtim me nevojat reale të qytetarëve të Kosovës, pastaj janë ndarë mbi 3 milion euro për Agjensionin për Veterinë dhe për Ushqim ende pa u miratuar ligji, i cili e përcakton se nën autoritetin e kujt do të jetë ky agjension. Kjo është shkelje ligjore, nuk mund të ndahet buxheti për diçka që nuk ka bazë ligjore, prandaj mendoj se këto janë disa prej argumenteve që ishte dashur me na mjaftuar që ky projektbuxhet në këtë dëgjim të dytë ta refuzojmë dhe të shkojmë në dëgjimin e tretë të tij. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Husnija Beshkoviq

DEPUTETI HUSNIJA BESHKOVIQ – Uvaženi predsednice Skupštine poštovani premiere predstavnicu Vlade, dame i gospodo poslnaici.

Mi danas na dnevnom redu imamo drugo čitanje zakona o budžetu za 2007. godinu, parlamentarna grupa 6 + na prvom čitanju iznela svoj stav ovom zakonu i posetu uvaženom kolege i vas is Vlade da smo mi ovaj zakon zakon o budžetu prihvatili u načelu, te predlažem da konačno poštujem dnevni red i da pređemo na glasanje amandmana i na konačno usvajanje zakona. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, z. Hyseni urdhëroni

DEPUTETI HYDAJET HYSENI- Ju faleminderit, i nderuari kryetar, të nderuar zonja dhe zotërinj ministra, i nderuar kryeministër, zonja e zotërinj deputetë.

Unë dua ta mbështes që në fillim në qoftë se krejt e zakonshme kryetarin e Komisionit për Buxhet në vlerësimin e tij se Qeveria kësaj radhe përsëri është vonuar në prezantimin e buxhetit dhe na ka sjellë një propozim shumë të ngatërruar, por për fat të keq kjo është e vetmja çështje të cilën mund të pajtohem me përfaqësuesin e Komisionit. Do të duhej shtuar këtij vlerësimi edhe përgjegjësinë që ka UNMIK-u në këtë çështje, UNMIK-u po e mban çështjen e buxhetit të rezervuar, por nuk mund të themi se edhe po e kryen si duhet pjesën e tij të përgjegjësisë. Ka shumë paradokse të cilave edhe zyrtarët e UNMIK-ut duhet t'u japin përgjigje, pse lejohen ato.

Kryetari i Komisionit tha se janë organizuar dëgjime publike, po ne përfaqësuesit e komisioneve të tjera nuk kemi marrë ndonjë ftesë për to, kurse janë çështje që na takojnë jemi të obliguar të japim kontributin tonë. Edhe komisioni për më tepër është vonuar në raportin e tij. Shikoni, ju lutem propozimin e amendamenteve, 18 dhjetor është data, cili komision do të mund të shqyrtonte amendamentet që të shihet a janë përfshirë çështjet që ne i kemi shtruar në debat publik apo jo, edhe në këtë sallë. Komisioni për më tepër ka bërë një raport të njëanshëm. Edhe kjo tërheq vërejtjen për shkak të procedurave të përgjithshme. Është një praktikë që nuk po korrigjohet se nuk po korrigjohet. Sipas rregullës 47.5 raporti duhet të përmbajë edhe pjesën e dytë, arsyet dhe opinionet e kundërta dhe komentet e komisioneve përkatëse dhe kjo nuk ka ndodhur. Komisioni

Legjislativ është detyruar dhe që ta shqyrtojë edhe një herë duke pas përfundimisht tekstin e amendamenteve dhe kur është konstatuar se nuk janë përfshirë çështjet që i kemi ngritur ka rekomanduar. Besoj se u është shpërndarë deputetëve, të rishqyrtohen zërat buxhetor që lidhen me drejtësi, gjyqësinë dhe Komisionin Antikorrupsion. Më lejoni vetëm për ilustrim: mjetet që janë ndarë për këshillin gjyqësor dhe për Komisionin Antikorrupsion ju e merrni me mend rëndësinë që kanë këta trupa për sundimin e ligjit në Kosovë, janë qesharake, janë më të vogla zonja dhe zotërinj sesa që merr një ministër, përkundër pagës që ka vetëm për pjesëmarrje në disa borde për mua shumë problematik dhe përsëri e shtroj pyetjen; Si lejon administrata ndërkombëtare paradokse të tilla? Kështu sigurohet sundimi i ligjit, për më tepër zonja dhe zotëri për propozimet që janë bërë shpejt e shpejt dhe deputetët t'ju sigurojnë nuk kanë pas kohë që t'i shqyrtojnë dhe t'i konsultojnë amendamentet e Komisionit.

Ka edhe propozime që janë absurde që janë pa asnjë justifikim dhe e shtojnë absurdin e propozimeve të mëparshme me ndarje buxhetore një milion për këtë instiucion ,dy milion për këtë tjetrin, 3 milion për fondet e rezervuara . Shtrohet pyetja si u bë që nevojat buxhetore qenkan gjithmonë të rrumbullakuara, një milionm dy milion tre milion? Duket qartë që janë krejt paushalle .

Për më tepër unë dua të tërheq vërejtjen se pa pëlqimin e këtij Kuvendi janë ndarë 1 milion e 200 mijë euro për vilën shumë problematike në Gërmi dhe jam i sigurt të dështuar edhe pas këtij mandati , Prandaj unë mendoj që duhet mbështetur propozimet e shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe Kuvendit dhe opinionit kosovar i duhet dhënë mundësia që të marrë pjesë në ndërtimin e buxhetit më të mirë ,më të rregullt. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Enver Hoxhaj,

DEPUTETI ENVER HOXHAI – I nderuari z. kryetar, i nderuari z. kryeministër, të nderuar ministra.

Unë do të synoj që në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji ,Rini dhe Sporte, më tepër përmes gjuhës dhe fakteve t'i reflektoj qëndrimet e Komisionit tonë. Nëse kjo qeveri e ka pas prioritet arsimin me programin e saj të rinjve , më lejoni vetëm t'i bëj me dije që buxheti i cili është ndarë për arsim është 4.7% euro nga krejt buxheti i përgjithshëm. Kjo tregon se sa dhe çfarë mbështetje do të ketë sistemi i arsimit dhe nëse reformat në arsim këto 7 vitet pas luftës janë prezantuar si prioritet i çdokujt me një buxhet i cili përfaqëson vetëm 4.7% të buxhetit të gjithmbarshëm të Kosovës, tregon se këto reforma do të mbesin aty ku janë . Për neve si komision ka qenë absurd që buxheti i cili është ndarë për mallra dhe shërbime asht në përmasa të tilla të mëdha, mirëpo Komisioni ka synuar të ofrojë zgjidhje pragmatike e cila do të duhej vërtet që të jetë në interes të arsimit në Kosovë,

S'po flas për kategorinë e shkencës ku fare nuk e dimë çfarë do të ndodhë me shkencën, s'po flas për kategorinë e rinisë , fushë të cilën e mbulon ,ku fare nuk e dimë se çfarë do të ndodhë me rininë , s'po flas as për kategorinë për çështjen jo rezidente ,që fare nuk e dimë se çka do të ndodhë, vetëm po e reflektoj qëndrimin e Komisionit sa i përket fushës së arsimit dhe qëndrimin do ta reflektoj me një formë pyetjes.

Ministri për Financa a ka llogaritur se cili ose cila do të jetë mbetja buxhetore ,suficiti buxhetor, nga ky vit. Nëse ka suficit buxhetor më lejoni në emër të Komisionit të kërkoj që gjysma e këtij buxheti të përdoret në dobi të arsimit, Përveç kësaj ne si Komision dje kemi pasur një mbledhje ku kemi ftuar ministrin e Arsimit dhe ministrin e Kulturës me një qasje të natyrës pragmatike që qoftë edhe 15 edhe 20 milion euro të gjendet mundësia të bartet nga një vit buxhetor në një vit tjetër buxhetore, arsyet për mospjesëmarrjen në takimin që kemi pasur në ditën e djeshme, mund të jenë të shumtë ministrat që e kuptojnë ndoshta gjendjen e ngarkuar, mirëpo arsyeja për mospjesëmarrja edhe te zëvendësministrit ose të zyrtarëve të tjerë, pothuajse është absurde, kështu që shqetësimin që do ta ketë Kosova gjatë vitit 2007 do të jetë shumë më i madh seç kemi pas gjatë kësaj kohe dhe numri shkollave të cilat janë ndërtuar vetëm në qytetin e Prishtinës në këto 7 vitet e fundit mund të numërohen në gishta të dorës, kështu që kërkoj nga Qeveria e Kosovës, nga kryeministri- nëse vërtetë këtë buxhet do të duhej t'ia dedikojë një pjesë të caktuar arsimit disa vende- buxheti për arsim është rreth 30% a të mendoj se forma e modalitetit si ta arrit buxhetin për arsim gjatë vitit të ardhshëm.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Besa Gaxheri

DEPUTETJA BESA GAXHERI – Ju faleminderit z. kryetar, zoti kryeministër, kolegë të nderuar.

Buxheti i konsoliduar i Kosovës prej 717 milion është me të vërtetë shumë i vogël për kërkesat që ka Kosova, por unë nuk pajtohem,quhet buxhet i mjerimit. Kur duam të bëjmë vërejtje për shumën apo të hyrat duhet ta keni parasysh pozicionin juridik të Kosovës, të hyrat nga vijnë të hyrat në buxhetin e Kosovës kompetencat për hartimin planifikimin, politikat fiskale të cilat nuk varen gjitha prej nesh,kufirin e këtij buxheti të cilin deri diku e kontrollon Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Unë mbështes këtë buxhet duke pas parasysh vërejtjet e kolegëve që janë me vend deri diku por si ekonomiste e kam parasysh dhe e kam shumë të qartë nga i kemi të hyrat buxhetore dhe me këto të hyra sa i kemi asht e vërtetë që ndoshta një organizatë buxhetore ka nevojë ma shumë për këto janë këto. Por unë desha t'i jap vërejtjet e mia ,sepse megjithatë është e vërtetë se buxheti është i vogël për nevojat e Kosovës por menaxhimi mund të bëhet më i mirë, para se me i dhanë krejt dy vërejtje për mos me i përsëritur kolegët e mijë dua të shtojë edhe këtë sepse unë jam dy mandate në këtë komision dhe shohë përparim sidomos në përgatitjen teknike të buxhetit të konsoliduar të Kosovës,

Andaj dua të them se ne po bëjmë përvojë dhe dua të pajtohem se jemi ma të mirë sot se dje, por nuk pajtohem po e marrë shembull konkret, buxheti i cili është planifikuar të ndahet për agjencinë kosovare të mirëbesimit mbi 75 milion euro. Kolegë të nderuar kjo farë mbretërie që punon dhe funksionon në Kosovë dhe nuk është në gjendje asnjë herë ti jep raport këtij Kuvendi që taksat e këtij populli të varfër i merr i shfrytëzon për raportuar kurë dhe ju z. të nderuar ministra jeni tek fund i fundit persona politik, dua ta gjeni forcën dhe t'i kërkonit këto edhe në qoftë se vërtetë është kompetencë e rezervuar, duhet të kërkonit pse nuk raportohet për gjithë këtë shumë të kërkuar nga taksat pagues të Kosovës, pastaj keni parasysh mjetet e privatizimit, ku janë, pse janë, pse nuk vihen në shfrytëzim në Kosovë, kushtimisht po e marrë shembull, gjithë këto mjete sikur të kishin hy në qarkullim, ta marrim shembull në bujqësi do të ishte një situatë krejt tjetër, shembullin tjetër, 48 milion ndahen për energjetikë, ju lutem shumë, taksa paguesit e Kosovës paguajnë nga dy herë energjinë elektrike, kjo është e pa pranueshme, definitivisht e pa pranueshme dikush duhet të japë llogari, tek fundi i fundit, ne në radhë të parë si deputetë por edhe ju si ministra si qeveri keni obligim delni para qytetarëve dhe të pranoni pse po ndodhin këto gjëra, të jeni ma transparent.

Unë nuk pajtohem me bordin e AKM-së e aq ma shumë kur ne kemi disa ministra në këtë bord, duhet të jeni transparentë dhe duhet të kërkonit që kjo agjensi të na bien në raport pse i kërkon këto mjete dhe ku i shpenzon këto mjete, po e shtoj edhe trusin pensional, tash më ka kaluar një kohë që nuk paska siguri në Kosovë, Kosova ka nevojë gjithë ky debat që bëhet nga kolegët është i pranueshëm sepse ne kemi nevojë, e kemi gjendjen shumë të rëndë ekonomike ndërsa fonde në sasi shumë të mëdha janë të ngrira jashtë Kosovës, kjo është e pa pranueshme andaj unë kërkoj një përgjegjësi apo guxim e jo një servilitet kaq të madh të qeverisë sonë, dalin para popullit dhe të shpjegojë këto pse po ndodhin. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – I nderuar kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra i nderuar ministri Shatri, është praktikë parlamentare ku do do ta quaja së paku në Evropën Juglindore së paku bëjmë pjesë edhe ne që buxhetit të mos përkraket nga opozita është diçka shumë normale, mirëpo është po ashtu normale në cilin shtet që pak pretendon që është shtet që bazohet në sundimin e ligjit është shtet i së drejtës që gjithçka me një shoqëri të organizuar duhet të shkojë konform ligjit, dhe këtu janë vërejtjet themelore të cilat i adresojmë lidhur me këtë shqyrtim të këtij projektbuxhetit që sot po e bëjmë. Kemi pas informata mjaftë të cungime mjaftë të mangëta, jemi mundur si komision buxhetit të kërkojmë informata shtesë na kanë ardhur, e s'na kanë ardhur. Puna dhe pasqyra që po na vijnë janë vazhdimisht ma të cunguara, nuk po ka materiale shtesë në disa momente edhe po përpiqemi që të jepni materiale shtesë por në disa momente tjera po i mbyllni, Psh. tabela kryesore e buxhetit ma nuk vjen me referencë me buxhetin paraprak, por vjen vetëm buxheti i këtij viti, hera e dytë që na vjen tabela kryesore e buxhetit pa referencë të vitit paraprak që për ko do që të përpiqet të bëjë një analizë dhe që nuk e ka dokumentacionin e ka vështirë ta bëjë analizën.

Po ajo ku desha unë të ndalem është te një moment delikat gjatë miratimit të këtij draft buxheti në Qeveri, 14 komuna të nderuar kolegë deputetë nuk e kanë përmbushur kriterin elementar të kërkesave që parashtron ligji për menaxhimin e financave publike, 14 drejtorë financiarë nëpër ato komuna kanë dështuar në zbatimin e ligjit dhe i ndërruar ministra unë kërkojë këtu nga ju që të na jepni sqarimin çka keni ndërmarrë ju ndaj atyre 14 komunave, konform këtij ligji që e kemi sot në trajtim dhe shqyrtim shihet se nuk keni ndërmarrë asgjë vetëm keni konstatuar se 14 komuna kanë dështuar me përmbushjen e obligimeve ligjore mirëpo nuk e kemi asnjë informacion se çka keni ndërmarrë ju, ndërkohë që edhe obligimet e tyre zyrtarëve komunal në komuna konform me menaxhimet financave publike e definojnë shumë qartë përgjegjësinë, janë nenet 17, 18 dhe 19 të cilat kanë të bëjnë drejtë për drejtë me dokumentet të cilat duhet plotësuar nga zyrtarët e financiarët e organizatave buxhetore lidhur me përvetësime buxhetore neni 17.5 e thotë shumë në mënyrë taksative deri më 15 prill ministri i Ekonomisë dhe Financave do të dërgojë gjithë drejtorëve financiarë gjithë organizatave buxhetore një doracak mbi buxhetin, kurse drejtori financiar i së cilës organizatë financiare do të jetë përgjegjës për përgatitjen e propozimit buxhetit, po ashtu neni 63 i ligjit për menaxhimin e financave publike po ashtu e thotë në mënyrë taksative e përshtet rastin kur ndodhin shkeljet nga zyrtarët apo nëpunësit publik . Nëse ndonjë zyrtar publik ose nëpunës publik me qëllim dështon apo më shumë se një herë dështon me neglizhencë tu bindet një apo më tepër obligimeve dhe kërkesave të vendosura nga ky ligj, zyrtari i tillë publik apo nëpunësi do të përjashtohet dhe do të ndalohet punësimi në shërbimet publike për një periudhë së paku 3 vjeçare, 63.2 nëse ndonjë zyrtarë publik apo nëpunës publik me qëllim dështon tubimet një apo më shumë obligimeve, apo dështon në zbatimin e rekomandimeve -dënohet, pason dënimi administrativ deri në 10 mijë euro, duke pasur parasysh që 14 komuna të Kosovës e të cilat janë: Obiliqi, Podujeva ,Prishtina, Leposaviqi, Mitrovica, Kamenica, Novo Brda e të tjera, nuk i kanë përmbushur kriteret elementare të cilat duhet të plotësohen sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike. Ju nuk e keni parë të arsyeshme as t'ua ndalni grantet qeveritare të cilat do të ishin një rrjedhojë shumë normale e ndëshkimit për këta zyrtarë nëpër ato komunat të cilat kanë dështuar në përmbushje të ligjit. Ju as këtë nuk e keni bërë e le ma të shkoni dhe të aplikoni në nenin 63 i cili parashih sanksione dhe ndëshkime për zyrtarët të cilët e trajtojnë ligjin sipas tekeve të tyre. Prandaj, duke pasur parasysh ato që u thanë më herët,nga parafolësit, posaçërisht mosrespektimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe mospërputhjen e normave ose moszbatimin e normave nga ana e zyrtarëve financiarë nëpër organizata buxhetore rrjedhimisht moszbatimin e normave nga ana e ministrit për Ekonomi dhe Financa ,ne si parti opozitare sigurisht që nuk do ta përkrahim edhe ashtu, është e logjikshme që nuk do ta përkrahim, po jemi shumë në dilemë se a do të marrim fare pjesë në procesin e miratimit të tij,pasi që konstatohen kaq shumë shkelje, prandaj mendoj se e mira e së mirës është që ky ligj edhe një herë të merret nga Qeveria edhe të shihet cilat janë mundësitë për përmirësimet që kërkuan parafolësit e mi dhe posaçërisht insistoj që ministri të dalë dhe të na dokumentojë se çka kanë ndërmarrë ndaj shkelësve të ligjit.

Cilat janë sanksionet që i ka ndërmarrë ministri ndaj atyre dhe cilat nuk i kanë zbatuar normat e ligjit. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, ministri Dugolli

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Kryetar, si deputet dua të flas këtu faktikisht përshtypja po ndihet se gjoja se jemi në leximin e parë e jo në leximin e dytë ,sepse ka atë retorikën e diskutimeve si nga leximi i parë edhe në leximin e dytë. Ne do të jemi realë çdo agjencisë shpenzuese i ka nevojat e veta, të cilat nuk përmbush ky buxhet, po ne duhet të jemi realë , të punojmë në bazë të këtij buxheti dhe në rast se këtu u thanë se ka pasur vonesa ,atëherë të mos bëhet shkaktar që vonesa të vijnë nga një mekanizëm tjetër që të mos miratohet apo të shtyhet buxheti, procedura thotë që në leximin e dytë pas vërejtjes që japin komisionet funksionale dhe amendamentimi duhet të shkohet me procedurën e votimit të amendamenteve të Komisionit funksional, edhe agjencitë shpenzuese duke përfshirë kërkesat që i bëhen Komisionit funksional dhe ato që i kanë marrë parasysh në fazën e rishikimit që të bëhen aty ku ka mundësi rishikimi që të plotësohen disa linja.

Ju e dini që çështja e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit është kompetencë e rezervuar e Qeverisë . Ky Kuvend ka miratuar rekomandimet e njëpas njëshme dhe asnjëherë nuk janë marrë seriozisht nga faktori ndërkombëtar UNMIK-u, që të ketë transfer të kompetencave në politikat e privatizimit .të menaxhimit të fondit të privatizimit të ndërmarrjeve publike.

Unë kërkoj që edhe Kuvendi ,Kryesia, kryetari i Kuvendit, të gjithë shefat e grupeve parlamentare ,në rast se dëshirojmë të kenë përgjegjësi të plotë nga përfaqësuesit e deleguem, atëherë të insistojnë që transferi i kësaj fushe të bjerë sa më shpejt në kompetencë të Qeverisë të Kosovës. Ne jemi dy ministra aty,çdoherë kemi dhanë vërejtje sa i përket buxhetit. Ky buxhet për AKM-në shkonë kryesisht subvencione për ndërmarrjet publike dhe Trepçën, na është premtuar se transfer që do të ndodhë shumë shpejt dhe menaxhimi i këtij buxheti do të bëhej nga Qeveria e Kosovës, prandaj është kërkesë jona të insistohet nga gjitha mekanizmat e institucioneve të Kosovës të ndodhë transferi i vërtetë, kosovarizimi i bordit të AKM-së jo në këtë përbërje si është tani. Çështja e fundit e privatizimit është çështje politike .Ai nuk mund të zhbllokohet. Edhe pas shumë kërkesave që ne i kemi bërë nuk është zhbllokuar dhe as që parashikohet të zhbllokohet para se të zgjidhet statusi i Kosovës.

Të gjitha këto që u diskutuan i kemi ngritur,por tjetër është kërkesa që i kemi bërë dhe fuqinë që e kemi pas, prandaj unë kërkoj që ta kemi këtë fuqi, mbështetëse edhe nga Kuvendi që të ndodhin sa më shpejt . Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Gani Koci E ka fjalën Genc Gorani

DEPUTETI GENC GORANI – ju faleminderit z. kryetar, i nderuar z. kryeministër, kabineti qeverisës, të nderuar zonja dhe zotërinj kolegë.

Unë desha vetëm shkurtazi ta marr fjalën në lidhje me dy çështje të vogla të shtojë në këto të gjitha që u debatuan deri më tani. Sipas informatave që i kemi pas në kuadër të Komisionit funksional për Energetikë, përfaqësuesi i Ministrisë së Financave ka deklaruar se kërkesa buxhetore për plotësimin e obligimit ligjor për tekstet e shkollimit falas për ciklin obligativ të shkollimit fillor, që kjo kërkesë nuk është parashtruar aspak nga ana e ministrit të Arsimit. Shtesë, si argument për të thuhet se është fjala për një shumë meramendëse për 51 milion euro ,andaj edhe kjo nuk ka hyrë në shqyrtim aspak. Në replikën time personale që nuk është fjala aspak për 51 milion, por është me siguri për fondin 6 ose 5 milion. Ky ministër thotë, përfaqësuesi i Ministrisë së Financave pat deklaruar se nuk e ka këtë informatë. Ekziston një kakofoni e informatës Ministra e Financave nuk jep informata të sakta se çfarë ka qenë kërkesa dhe për çfarë kërkesë buxhetore është fjala..

Nga ana tjetër ,kur i bëhet kërkesa që ta kenë këtë informatë, ata thonë nëse ju duhet e shkruar ejani na pyetni neve, ne ju themi se në mungesë të informatave elementare dhe me informatat të cilat janë jashtëzakonisht të natyrës **agreguese** ku njeri nuk mund të nxjerrë kurrfarë konkludimi, është shumë vështirë të merret përgjegjësia e votimit për çka do qoftë e aq më pak të votohet në tërësi .Kërkoj përgjigje nga ministri i Financa dhe nga ministri për Arsim. Pra, ky e ka bërë kërkesën dhe në çfarë lartësie, sa është ai zë buxhetor dhe nga ministri për Financa çka është vendos, është aprovuar apo jo dhe me çfarë arsytimi.

Është shumë vështirë të merret përgjegjësia për votim kur ne e kemi një buxhet 75 milionësh të akorduar për AKM-ën që u përmend këtu. Dhe përfaqësuesit tanë politikë nuk e kanë gjet mënyrën deri tani të raportojnë nëse jo në mënyrë formale, së paku në mënyrë informale këtu para Kuvendit. Ata e marrin si alibi se nuk mund ta bëjnë këtë, sepse janë munduar atje në kuadër të forumit të bordit t'i ngrisin çështjet. Nga ana tjetër të gjitha faktet po tregojnë se ata nuk janë përveç se bashkëpunëtorë të vendimeve që janë bërë në AKM. Le të urdhërojnë le të raportojnë le t'i bijnë procesverbalet, le ta kuptojnë se çfarë qëndrime kanë pas aty, atëherë ne mund të diskutojmë. Tani për tani ata vetëm kanë bashkëpunuar dhe asgjë tjetër. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. deputeti Behxhet Brajshori e ka fjalën.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – I nderuari kryetar i Kuvendit, kryeministër , të nderuar ministra dhe kolegë deputetë . Nuk do të doja të kthehem në një pjesë për cilën ndoshta kemi biseduar para tri javësh ,tri ditë për afërsisht, se çka mund të bëhet me qëllim të rritjes së fondeve buxhetore ose të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, sepse këtë e kemi thënë në leximin e parë të gjithë deputetet bashkërisht që janë angazhuar . Mendoj se do të ishte një kohë pak a shumë joracionale që ne tash të kthehem të shohim cilat janë mundësitë për të rritë Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës më shumë.

Por unë do të ndalem pak në procedurat buxhetore dhe natyrisht në kohën e nevojshme për aprovimin e buxhetit për vitin 2007. Nuk ma merr mendja se mund të kemi një komoditet të atillë që ne të mos jemi më këmbëngulës për ta aprovuar buxhetin i cili,

flas në cilësinë e deputetit në këtë rast, i cili ndoshta është gati hera e parë që megjithatë për një nuancë ndoshta pak i vonuar, por me gjithë atë është në kohë. Nëse e shtrojmë pyetjen çka nëse nuk aprovohet buxheti dhe kalojmë në muajin janar, ku secili prej nesh duhet të ketë kërkesa të veçanta për shpenzimet e veçanta, por edhe personale. Një praktikë të tillë ne e kemi pas para një viti jo më shumë dhe natyrisht sipas autoriteteve, të dhënave dikush e ka respektuar ose e ka shfrytëzuar autoritetin e tij dhe ka vendos sipas Kornizës Kushtetuese për të nënshkruar një të dymbëdhjetën e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për të vazhduar me funksionimin normal të institucioneve. Nuk ma merr mendja se duhet të bëjmë një hap të këtillë, sepse po që se ndalem dhe pyesim secilin prej nesh edhe këtu që është në sallë edhe ata që nuk janë në sallë sot, ju garantoj se secili prej nesh do të vinte prioritet e veta të caktuara. A është e mundur që të respektohen prioritetet individuale? Jo. A është e mundur që të respektohet prioritetet edhe të agjencioneve shpenzuese individualisht? Jo. Qeveria respekton prioritet e dhëna në kuptim të diskutimit buxhetor që kemi pas hiq më pak se sa mund të them lirisht tërë vitin 2006 po në veçanti në periudhën e caktuar edhe me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike. Kur kësaj ja shtojmë edhe periudhën pas leximit të parë të ligjit, ku Komisioni për Buxhet ka punuar aktivisht në këtë drejtim, janë gjetë zgjidhjet më të pranueshme të mundshme. Unë nuk e them se janë ideale, unë nuk e them se është shumë real, por e them se është e mundshme, në kuadër të mundësive buxhetore që i kemi.

Prandaj, mendoj se duhet të jemi më racionalë në këtë dhe unë kam thirrjen për të gjithë deputetët, jo vetë të pozitës, por edhe të opozitës, me gjithë korrigjimet që mund të bëhen në fazën e dytë të implementimit të buxhetit gjatë rishikimit ta votojmë buxhetin, sepse buxheti është një nga momentet më të rëndësishme për të siguruar stabilitet të funksionimit të institucioneve në përgjithësi.

Prandaj, jo vetëm deputetët në sallë, por edhe deputetët që nuk janë në sallë kolegjalisht edhe si deputetë pra, unë i ftoj që të marrin pjesë në një akt i cili vërtet është shumë i rëndësishëm dhe të vazhdojmë me punë kuadër të përmirësimeve që mund t'i bëjmë në përgjithësi në procedurat buxhetore për vitin e ardhshëm. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Janë paraqit për diskutim edhe Emrush Xhemajli, Gjergj Dedaj dhe Ymer Muhaxheri d. Urdhëroni z. Xhemajli.

DEPUTETI EMURSH XHEMAJLI – Z. kryetar i Kuvendit, z. kryeministër, ministra, kolegë deputetë dhe gjithë ju që jeni prezentë.

Në leximin e parë të Projektbuxhetit për vitin 2007 u dhanë shumë vërejtje dhe fatkeqësisht ato nuk janë marrë parasysh. Pajtohemi me vërejtjet që u bënë këtu, na e dimë buxhetin e Kosovës. Këtu u tha se grupet parlamentare në detaje kanë shikuar linjat buxhetore edhe i paskan harmonizuar.

Unë këtu do të ndalem te linja buxhetore, rezerva për statusin e Kosovës, këtë e kuptojmë. Do me thanë të gjithë e kuptojmë çka do me thënë kjo. Këtu janë nda 3 milion e gjysmë e diçka më tepër. Ndërkaq unë nuk po e kuptoj, duhet të sqarohet jo vetëm për mua, jo vetëm deputetëve, por edhe opinionit çka do me thënë vija tjetër buxhetore

bisedimet për statut. Këtu kemi rezerva për statusin e Kosovës, në rregull. Por bisedimet për status, por gjithëkush në Kuvendin e Kosovës ka thanë se do të vazhdojnë bisedimet edhe më tutje. Përkundrazi ja këtu e paskam kryeministrin Çeku, e paskemi tjetrin anëtar të Grupit Negociator z. Kolë Berisha edhe tjerët e kanë thanë në media. Gjithë po thonë se nuk ka më bisedime, pse atëherë duhet të ndahet një milion për këtë? Ju lutem dikush le ta shpjegojë këtë. Unë nuk kërkova asnjë vijë buxhetor të bartet këtej apo andej, por të hiqet kjo krejtësisht, sepse kjo fare nuk është nevojshme, ose na tregoni sinqerisht kush e ka shti këtë, bisedimet për statusin. Faleminderit. Dua sqarim ju lutem.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Gjergj Dedaj e ka fjalën.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Faleminderit shumë z. kryetar. I nderuar z. kryeministër, ministrat, kolegë deputetë. Po më vjen mirë që kur po bisedohet për buxhetin e tërë Qeveria pothuajse komplet është këtu. Shpeshherë kur kemi biseduar për çështje kryesiale ndoshta edhe për statusin shumë pak i kemi pa ministrat edhe anëtarët e Kabinetit qeveritar. E kuptoj arsyen.

Unë si deputet, do me thanë konsideroj se nuk ka pas transparencë të mjaftueshme gjatë menaxhimit dhe shpenzimit të parave të qytetarëve të Kosovës, tatimpaguesve të Kosovës.

U përmendën nga parafolësit një sërë lëshimesh, dështimesh dhe keqmenaxhimesh dhe ta votosh do me thanë një buxhet për vitin e ardhshëm kur këtë vitin që po e kalojmë ka pas shumë dështime do të thosha t'ua japësh edhe një infuzion më tepër dështimeve edhe kësaj Qeverie që sipas mendimit tim personal i ka skaduar afati, do me thanë është qëndrimimi personal si deputet i ka skaduar afati i legjitimitetit i kredibilitetit dhe mendoj se tash ta mbështesim t'i japim prapë pra edhe për bisedime që po thonë s'ka bisedime do të bëjnë bisedime, sikur që na kanë mashtruar disa herë. Do me thanë kjo është nonsens dhe unë konsideroj se si deputet opozitar ky buxhet nëse miraton pozita e miraton për veti, për pozitën dhe për nevojat shpeshherë personale të ministrave dhe të kabinetit qeveritar, sepse po sillen me buxhetin e Kosovës si me ja pas lanë baba amanet, do me thanë ka aq shumë raste, ndoshta duhet një orë për me folë për të gjitha ato lëshime, ato keq menaxhime. Unë mendoj se nuk e shohim të arsyeshme që më tutje të vazhdojmë lidhur me këtë çështje dhe nuk e mbështesim këtë buxhet për vitin 2007.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. prof. Muhaxheri e ka fjalën.

DEPUTETI YMER MUHAXHERI – Kuvendi i nderuar, z. kryetar. Edhe pse nuk jam i thirrur në aspektin e njohurive kompetente kur është fjala për buxhetin, megjithatë kam një vërejtje që ka të bëjë me ndamjen makro të buxhetit të Kosovës, veçmas në dy pozicione, ku flitet për AKM-en dhe KEK-un.

Parafolësit e mi e theksuan atje se kjo çështje lidhet me transferin e kompetencave, është fakt, por çështja e AKM-ës kishte me u zgjidhur sikur ta kishim pas një angazhim të ministrit të Financave dhe të kryeministrit, jo një herë, por disa herë me ju drejtua Zyrës Ligjore në Nju Jork që mjetet e depozituara në banka të huaja të privatizimit, për

këtë vjet t'u u mbështet në gjendje e vështirë shoqërisë kosovare, me bë përjashtim dhe ato 60 e sa milion në një mënyrë me i marrë për këtë rast specifik e me e lehtësua këtë gjendje.

Çështja e KEK-ut, shoqëria kosovare para 6, 7 vjet ka ditë me ndejtë në resht me pagua obligimet e rrymës. E njëjta shoqëri edhe pse ka ndodhë lufta, 30%, 36% edhe krenohemi me atë mbledhje të asaj, ku është ai mobilizim, a mund të jetë fakt që 5 vite në kuadër të buxhetit vetëm e prolongojnë këtë fond të tyre dhe ata çlirohen dhe nuk i japin forcë mobilizimit, angazhimit të këtyre dyjave.

Këto dy pozicione, dy konto të mëdhenj në këtë buxhet kishin me siguruar një shumë prej 100 milion kish mujt me intervenu në politikën sociale ,veçmas për pensione, gjyqësi dhe shëndetësi. Duhet me pas ndjeshmëri ndaj shkallës së pakënaqësisë shoqërinë kosovare.

Këto tri segmente janë ato që e kanë mëri kufirin e durimit. Vetëm një xixë, një shkëndijë e vogël mjafton për me shpreh një mos kënaqësi ,një çrregullim në momentin më kritik kur duhet me ekzistua një stabilitet shoqëror.

Kam vërejtje se Qeveria, në përgjithësi, posaçërisht këto dy personalitete bartëse të kësaj jo një herë po njëqind herë me kërkua audiencë në Zyrën Ligjore dhe me qenë të gatshëm me shpreh një mos disiplinë, e kjo mos disiplinë është një flijim që kërkohet edhe prej Qeverisë edhe prej këtyre dy personaliteteve. Jam i bindur se me një angazhim më të fuqishëm në këtë gjendje kishim me i ndihmua shoqërisë kosovare. Kaq. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Për shkak të situatës së krijuar marrim pauzë dy orë. I lus shefat e grupeve parlamentare të vinë në zyrën time të bisedojmë. Fillojmë në orën 14,00.

Vazhdimi i seancës pas pauzës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Të nderuar kolegë, me qenë se nuk kemi numrin e mjaftueshëm për të filluar punën, kemi prezentë vetëm 56 deputetë, nuk mund të veprojmë më tutje. Dëshiroj mendimin e dy shefave të grupit parlamentar për kur ta lëmë seancën tjetër, apo po mendoni për të martën. Urdhëro ministër.

MINISTRI FATMIR REXHEPI – I nderuari kryetar, të nderuar deputetë. Duke e ditë se buxheti do të thotë është një ndër çështjet më të rëndësishme për Parlamentin dhe për Qeverinë e cila e udhëheq vendin, unë konsideroj që pavarësisht këto veprime çka i ka bërë opozita mendoj se përgjegjësia është jona. Kryekëput i bie Kryesisë së Parlamentit për arsye se nuk është e rrugës që brenda dy javëve të fundit ,bie fjala, kur dihet që trajtohen çështjet buxhetore në Parlament, komisionet parlamentare deputetët e caktuar të ecin ,të shëtisin nëpër Evropë, aq më parë t'u i ditë rrethanat tona. Asnjë punë nuk ka

qenë më e rëndësishme se sa të aprovet buxheti i Kosovës për me muajt me funksionue gjatë vitit tjetër institucionet tona.

Prandaj edhe këtu e shoh një lëshim shumë të madh. Përkundër angazhimit të shkëlqyeshëm e të madh që e ka bërë ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, ministria dëgjimet e Ligjit për buxhetin krejt organizimi flet diçka tjetër. Unë mendoj që duhet ta pranojnë përgjegjësinë tonë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Naser Osmani e ka fjalën.

DEPUTETI NASER OSMANI – I nderuari kryetar. Ne nuk mund ta ndërpresim seancën dhe të thirrjmë një seancë të re . ne mund ta ndërpresim kuptimin asaj që të vazhdojë nesër mbledhja, për arsye se të premtën me buxhet të aprovum në Kuvend, pa buxhet të aprovuar në Kuvend PSSP-ja do ta marrë vendimin. Vendimi i PSSP-ës në bazë të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike. do me thanë me nënshkrua versionin- draftin e Qeverisë ose të buxhetit të vitit të kaluar. Prandaj unë kërkoj nga ju që të bëni maksimumin që të arrihet një marrëveshje me partitë e tjera ose me partitë që mungojnë këtu që janë në koalicion që të vazhdohet seanca nesër, kështu që mos të ndërpritet që të thirret një seancë tjetër. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni ministër, ministri Shatri e ka fjalën.

MINISTRI HAKI SHATRI – Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë. Procedura dhe vendimmarrja për buxhetin e Kosovës për vitin 2007 dhe për cilindo vit tjetër buxhetor është akti më solemn më me përgjegjësi dhe më i rëndësishëm që e ndërmarrin institucionet e një vendi, në këtë rast edhe të Kosovës. Kam shumë vërejtje ose ua zë për të madhe të gjithë atyre njerëzve të cilët janë përgjegjës në procedurën e përgatitjes dhe të miratimit të buxhetit e të cilët në momentin e caktuar në këtë moment sot mungojnë në këtë sallë, qofshin ata të pozitës, qofshin të opozitës.

Unë dua t' jua përkujtoj që aprovimi i buxhetit nuk është i dobishëm vetëm për institucionet vetëqeverisëse në Kosovë,por është edhe një mesazh si procedurë dhe si akt që i përcillet faktorit ndërkombëtar në momentet aktuale. Pra është një akt edhe patriotik edhe shtetformues dhe nuk ka argument që na arsyeton për para kësaj neglizhence .Flas për deputetët e pozitës që nuk janë këtu dhe flas për deputetët e opozitës të cilët me tërë gojën flasin për interesin e popullit dhe flasin për interesat e Kosovës dhe flasin për vendimin për formimin e shtetit dhe në momentin kur nxirret dokumenti më kyç shtetformues ata mungojnë në këtë sallë.

Kisha kërkuar që kjo seancë të mos ndërpritet për të vazhduar nesër, të bëhen angazhimet maksimale nga strukturat përgjegjëse që të gjithë deputetët që kanë marrë rrogë 12 muaj, 3 vjet, në këtë Kuvend të vijnë këtu dhe të japin kontributin e vet qoftë për, qoftë kundër buxhetit, por të vijnë këtu dhe të jenë prezentë , sepse e kanë obligim edhe ligjor. Unë nuk i kuptoj ata që flasin 3 vjet më me ia rritë rrogat e nuk vijnë me marrë pjesë kur

votohet për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për ose kundër është e drejtë e tyre e garantuar. Faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit, a ka dikush tjetër. Urdhëroni prof. Hamiti.

SABRI HAMITI – Z. kryetar i Kuvendit, z. kryeministër dhe ministra të Qeverisë, kolegë të nderuar. S'është momenti mua po më duket, sepse jemi në një ditë pune që të bëjmë ligjërime politike për përgjegjësitë, sepse përgjegjësitë duhet t'i ushtrojnë të gjithë në partitë politike të cilat participojnë në këtë Kuvend.

Ky fenomen nuk është i pari në Kuvendin tonë, tashti është problemi që dikush e merr vesh më herët, dikush më vonë, dikush pa i ngja empirikisht diçka s'e kupton kurrë. Jam njëri prej atyre që kam ngritë zërin për një mos kujdesje në prani në Kuvend në momentet kur është votuar. Në çdo Kuvend të përgjegjshëm ekzistojnë kohët mund të mos jetë njeri këtu, por ekzistojnë kohët kur është obligative të jenë njerëzit këtu.

Kjo sot nuk ka ndodh, por nuk ka ndodh edhe disa herë, tash përgjegjësitë janë, dihet, Në këto raste janë dy farësh; një farë janë pozitivë e atyre që e bëjnë shumicën në Parlament, e prodhojnë një qeveri dhe e kanë obligimin ta kenë atë shumicë që t'i kalojnë ligjet themelore që i propozon ajo Qeveri.

Në anën tjetër ke dhe raste të tjera kur ajo shumicë nuk e bën shumicën e mjaftueshme për të kaluar ligjet që krijojnë një shumicë më të madhe. Këtu e tutje e marrin përgjegjësinë totale të barabartë edhe ata që e quajnë veten opozitë dhe janë opozitë në këtë Kuvend.

Por, kolegë të nderuar, unë them që duhet të provohet nesër të mbahet seanca, në qoftë dhe për tema të tjera. Por unë shoh diçka të veçantë këtu sidomos sot dhe këtë më duhet ta them para jush dhe publikisht.

Unë po shoh tendencën që jo të krijohet krizë qeveritare, por krizë parlamentare dhe kjo mua më bënë përshtypje shumë më të madhe, sesa ajo voton një opozitë, një buxhet apo s'e voton dhe dikush e tha këtu. Ne nuk jemi bërë Parlament sovran dhe e dimë shumë mirë dhe duhet ta di çdo njëri, e tentojmë të bëhemi Parlament sovran, ne nuk jemi qeveri sovranë e di çdonjëri që duke lexuar këtë buxhet do të duhet ta marrë me mend. Kjo i bije shkurtë, ne mund të luajmë lojta, sepse është dikush tjetër që do ta nënshkruaj atë buxhet, po, po e nënshkruan veç mos harroni, të gjithë do të jem më të vegjël politikisht nëse ndodhë ky akt. Edhe pozita edhe opozita, natyrisht pozita më shumë se e ka përgjegjësinë më të madhe. E unë po ju them që kjo hyrje në krizë parlamentare të padeklaruar do të jetë humbje jo për Parlamentin, por për Kosovën. Nuk është problemi vetëm i buxhetit, është problemi i pakos se ligjeve që do të na presin, janë ditët që e presin Kosovën me problemet që nuk do t'i përtheqojmë nëse punojmë 24 orë në ditë e jo 5 orë në ditë.

Unë ndjeva nevojë t'i them këto katër, pesë fjalë para jush, sepse unë i shoh problemet përtej asaj që duken si manifestim.

Kolegë të nderuar, megjithatë unë mendoj që duhet të kalohet shpejt në data të tjera. Ne kemi dhe pika të tjera të rendit të ditës, ne kemi dhe një orar të një seance të kërkuar nga opozita, që është e emëruar për nesër. Unë mendoj që duhet të provohet nesër të mbahet Parlamenti nuk ka arsye të jetë e drejta me një afat pacaktuar. Të provohet nesër, të mbledhet Parlamenti dhe të shqyrtojë detyra të tjera nëse jo veç njëjën. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Prof. Alushi e ka fjalën

DEPUTETI ALUSH GASHI – Z. kryetar. Në seancën e sotme nga radhët e Grupit Parlamentar mungojnë 3 deputetë, prej të cilëve dy marrin pjesë në vizitën në Strasburg, ndërsa një për arsye familjare ndodhet në Suedi dhe një mungon, por për ç'arsye nuk di.

Ne këta çka jemi brenda vendit vijmë në çdo kohë që na ftoni, por unë kam drojë që për tri mungesa ato do të vazhdojnë së paku edhe për një ditë apo dy, sepse janë jashtë vendit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. urdhëro ministër Dugolli.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Ne kemi informacion që po ashtu dy anëtarë të Grupit Parlamentar të Aleancës gjenden jashtë vendit, se s'di sa do të ndryshojë dita e nesërme sa u përket këtyre votave dhe ka informacione se nga Grupi 6+ i cili është pjesë e koalicionit, mungojnë për shkak të arsyeve dalin si jashtë vendit.

Unë mendoj duke u thirr në atë obligimin qytetar dhe obligimin që e kemi si parti qeveritare, votat e tyre mund të merren edhe në formë tjetër. Unë mendoj së mund të shtyhet për nesër, por mund të aprovojme ne sot, ashtu kështu Përfaqësuesi Special do të jetë ai që do ta nënshkruajë. Bojkotimet ne nuk mujmë t'i ndalojmë nga partitë opozitare, mund të ndodhë bojkotimi të vazhdojë dhe të bllokohet buxheti. Propozimi im është që të votojmë me amendamentet, deklarin e anëtarëve të koalicionit deputetë që janë jashtë vendit ta marrim në qoftë përmes shkrimit, qoftë pritët kur të vijnë ata dhe ta kalojmë procedura të tjera. Se ne nuk dimë bojkoti sa do të vazhdojë dhe a do të mund ta kryejmë ndonjëherë ligjin? Propozimi im është ne të vazhdojmë me amendamentimet dhe të kërkojmë deklarinet edhe të deputetëve të tjerë që nuk gjenden në sallë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryetar. Unë mendoj që duhet ta vazhdojmë seancën nesër me pika të rendit të ditës dhe në ndërkohë duhet me pas një organizim më të mirë për me qenë sikurse që do të kemi kuorum dhe atëherë mundemi me vazhduar me buxhetin. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Husnija Beshković.

DEPUTETI HUSNIJA BESHKOVIQ – Uvaženi predsedniçe. Çetiri člana parlamentarne grupe 6+ danas su prisutni ovde sednici, jedan član se nalazi na službeno putovanje u Stranburu, a jedan je iz zdravstvenih razloga danas odsuta. Predlažem isto tako da se nastavak sednice na ovu temu nastavi sutra, nastavimo sa ovom temom. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Nesër kemi seancë tjetër. Kemi pika të tjera të rendit të ditës. Ju lutem po bisedojmë, secili prej jush ka të drejtë ta marrë fjalën dhe të propozojë. Urdhëroni kush do të flasë. Behxhet Brajšhori, urdhëroni.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Z. kryetar, jo që do të them diçka të re, po është shumë urgjente që ne të ulemi e të aprovojmë buxhetin, do të doja angazhim konkret të Kryesisë së Kuvendit, angazhim konkret të shefave të grupeve parlamentare ne që jemi këtu, natyrisht, me emra për deputetët për të siguruar dhe seanca duhet të vazhdojë nesër me temën që e kemi prioritet dhe atë të buxhetit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. dikush tjetër? Rammadan Kelmendi

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Përshëndetje i nderuar kryetar. Unë vlerësoj se kjo pikë e rendit të ditës patjetër duhet të fillojë nesër ose sot të përfundojë dhe konfirmimi nga ata që nuk ekzistojnë mund të merret me metoda të ndryshme elektronike. Të bëjmë përpjekjen maksimale ata që janë brenda territorit të Kosovës gjithqysh nesër të jenë këtu prezentë. Ne akt më të madh juridik, pas Kushtetutës nuk kemi dhe nuk kam çka t'i shtojë atyre fjalëve që u thanë.

Vërtetë përgjegjësinë e bartim ne ata që nuk e respektojnë obligimet dhe përgjegjësitë e deputetit, janë të obliguar dhe duhet të jenë në doemos, për ndryshe nuk mund të arsyetohet mungesa e tyre. ju faleminderit. dhe nuk mund të vazhdohet me pika të tjera nesër pa u krye kjo pikë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI - Unë mendoj se është çështje paraprake krijimi i kuorumit për t'u mbajt seanca parlamentare e më pastaj vinë me radhë votat, ne nuk e kemi kuorumin edhe po të lejonte Rregullorja e punës së Kuvendit që të votohet nëpërmjet postës elektronike ne nuk e kemi kuorumin për ta mbajt.

Propozimi im është ta shtyjmë edhe për një orë seancë e sotme që tash ta ndërpremë për të vazhduar pas një ore, në mënyrë që mos po lëvizin gjërat dhe vetëdijësohet opozita që të jetë opozitë konstruktive e jo destruktive ta sjell krizën parlamentare në kohën kur Kosovën e presin vendimet e mëdha kur Kosovën e pret e ardhmja më e ndritshme.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit. Unë do të isha shumë i kënaqur në qoftë se problemi është veç te unë, kryesisht te unë, te mos organizimi im për këtë çështje. Por ata të cilët janë shefa të grupeve parlamentare e dinë çfarë përpjekjesh janë bërë dje e sot e për çdo ditë. T’ ju them një gjë që. Leje për vizita jashtë nuk jap unë. Unë i vërtetoj pasi t’i nënshkruajë shefi i Grupit. Ndonëse ka raste kur shkojnë edhe pa pyetur shefin e Grupit. Dhe nga grupi jonë parlamentar ka pas raste jo sot, por ka pas raste kur prej 47 deputetëve marrin pjesë vetëm 34. do me thanë nuk ke ku me lyp diçka tjetër, kur vet nuk je në rregull. Ne e kemi lanë disiplinën. Dhe institucionin e përgjegjësisë ka herë e kemi larguar. Do me thanë nuk kemi shtruar këtë çështje të mospjesëmarrjes së deputetëve në seancat plenare. Për një votë ne e humbim kohë të marrim vendimin. Unë prapë po them. Do të përpiqem, do të angazhohem aq sa kam mundësi, do të ishte fatlumësi për ju edhe për mua të ishte faji te unë, te mos angazhimi jonë. Me javë të tana kam biseduar me opozitën, me shefat e grupeve parlamentare edhe sot kemi biseduar bashkë. Edhe sot para se me hy në këtë seancë në mëngjes kemi biseduar në zyrën time. E kam biseduar me një nga një dhe me të gjithë së bashku. Kur ata lypin fjalën ta marrin edhe unë ia dhashë Gani Kocit që është diskutuesi i fundit i tyre, ata dalin përjashta. Pa e ditë se po votojmë apo s’po votojmë, pa e ditë rezultatin se cili do të jetë pas votimit, do me thanë e paragjykojnë, sepse kanë ardhur me qëllim që me dalë prej seancës edhe unë nuk kam mundësi me i ndalë ata të mos dalin.

E kuptoj shumë me rëndësi që është të votohet sa më shpejtë ky ligj nëse jeni për ata, nesër ta lëmë.

Gjylnaze Sylja, urdhëroni.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA - Faleminderit z. kryetar. Më lejoni edhe një herë të përsëris. Ne nuk guxojmë me e lënë bllokimin e institucioneve ashtu siç ju referu edhe z. Sabri Hamiti. Unë mendoj se ne nesër duhet me e vazhdua punën, njëkohësisht duhet ne shefat të vërtetojmë se kemi kuorumin Gjithashtu mundemi me e shtua sipas Rregullores e pastaj edhe votimin e buxhetit. Mendoj që kështu duhet të punojmë. Por nuk guxojmë me u nda, nesër duhet me e vazhdua punën edhe në bazë të asaj që se kemi kuorumin ne mundemi me e vazhdua edhe për buxhetin. Por së pari duhet vërtetua kuorumin se nuk kemi qysh me të vërtetë as nesër në qoftë se nuk kemi kuorum.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Këtë po e them edhe unë, a kemi mundësi ta kemi kuorumin.

Edhe tash kur jemi na këtu, dikush është t’u punua me opozitën për me ardhë në seancë dhe me siguri pa sukses. Po Sabri Hamiti nëse donë me tregua. Është presidenti i Kosovës, se nuk është e mështëftë ajo fare. Unë e njoftova dje për gjendjen si është, dhe ai është angazhuar.

Ministri Dugolli e ka fjalën.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Unë do të flas vetëm te çështja e kuorunit që po thuhet këtu. Ju e dini që ky Kuvend prej fillimit ballafaqohet me minus 10 vende, asnjëherë nuk

janë ardhur, njëqind herë është bërë shkelja e Kornizës Kushtetuese ndaj atyre vendeve të rezervuar dhe për çfarë kuorumi flasim na për kuorum normal. Z. Sabri Hamiti e tha fortë mirë se në çfarë baze veprojnë këto institucione.

Unë nuk mendoj që askush mundet na kundërshtua në veprim që këta deputetë që jemi këtu ta kryejmë votimin e ligjit, sepse kuorumi normal nuk është zbatuar në Kuvend e Kosovës prej ndërtimit të institucioneve deri sot. Ky është një lloj kuorumi fiktiv që thuhet në realitet nuk ekziston sepse 10 vende asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në parlament. Dhe kuorumi i nevojshëm ekziston qitu po të merret përbuzë ajo. Dhe unë e di që edhe Përfaqësuesi Special edhe UNMIK-u e ka për bazë këtë. Unë mendoj me votat që mund t'i marrim përmes postës elektronike nuk ka kurrfarë problemi që ne të vazhdojmë sot.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit. Ministri Gjini e ka fjalën. Me kartelë të Dugollit.

MINISTRI ADRIAN GJINI – Faleminderit kryetar. Mendoj se kemi kohë me marrë vesh shumë shpejtë kur kthehen deputetët tanë të cilët nuk janë këtu. Edhe nëse mujmë me marrë vesh për një gjysmë ore, kur kthehen ata, kemi më shumë se kur të nevojshëm, kemi vota më se të mjaftueshme edhe ta caktojmë të paktën atë diku kur do ta kuptojmë se ata janë këtu. Mendoj se për një gjysmë ore mund ta kuptojmë se kur kthehen, përmes telefonit. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Unë e kam edhe një propozim. Me qenë se nesër e kemi seancën tjetër të radhës të shohim opozita a po vjen këtu dhe të bëjmë përpjekje të fillojmë me këtë pikë.

Kamer Kameri e ka fjalën.

DEPUTETI KAMER KAMERI – Faleminderit z. kryetar. Unë kam një propozim tjetër ndoshta, me qenë se delegatët të cilët gjenden jashtë Kosovës sipas informacioneve mund të kthehen ditën e premte, atëherë unë kujtoj që mund të mbahet edhe ditën e shtunë me qenë se jemi në fund të vitit dhe është një çështje mjaft me rëndësi për miratim. Nuk ka gjë të keqe në qoftë se mbliidhemi të shtunë dhe të miratohet buxheti. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Për mua është e pranueshme. Urdhëro Naser.

DEPUTETI NASER OSMANI – Z. kryetar, gjërat janë shumë të qarta, buxheti në këtë Kuvend aprovohet ose deri të premtën paradite ose nuk aprovohet fare. Këto gjëra janë të ditura. Dita e fundit që duhet ta nënshkruajë z. Ryker është dita e premte..

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëroni z. Kosumi.

DEPUTETI BAJRAM KOSUMI – Ndoshta propozimi i fundit mundet me çelë derën më mirë dhe për kur vendosim. Nëse presidenti është duke folur me opozitën, nëse mund ta bëjmë për nesër kuorumin, nesër vendosim, por nëse nuk mund ta bëjmë për nesër kuorumin, shefat e grupeve parlamentare bashkë me Kryesinë e Kuvendit të marrin përgjegjësinë që të gjithë deputetët me qenë të shtunën këtu. Unë e di për atë çka po thotë Naseri për PSSP që e nënshkruan, por nuk e nënshkruan nëse Kuvendi i thotë se ne e miratojmë të shtunën, nuk e nënshkruan ai Projektligjin për buxhet. Ne e miratojmë pastaj e nënshkruan ai. Nëse ne i themi se të shtunën e miratojmë mos keni derte se ai nuk e nënshkruan. Prandaj, ndoshta kjo është rruga më e sigurt.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – A pajtoheni me këtë propozim? Një miratim formal. Ju faleminderit.

Nesër fillojmë me seancën për të cilën e kemi marrë rendin e ditës, kurse të shtunën do të dalim me buxhetin.

Vazhdimi i seancës 22.12.2006

Të nderuar kolegë! Mirë se keni ardhur ne seancën plenare Aktualisht i kemi 61 deputetë në sallë që do të thotë mund të punojmë. Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve.

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 31 gusht 2006. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit ia kanë paraqitur rekomandimet për amendamente.

Në bazë të raportit të Komisionit kryesor dhe Komisionit për Bujqësi, Pylltari e Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si dhe të Komisionit funksional raportues, në vijim jepet radhitja e rekomandimeve dhe e amendamenteve në tekstin e Projektligjit për mbrojtjen e bimëve si vijon

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për mbrojtjen e bimëve ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për mbrojtjen e bimëve dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e këtij Projektligji dhe amendamentet e tyre e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj kemi mundësi të fillojmë me votimin e amendamenteve një nga një

Amendamenti nr. 1

Lus regjinë që të përgatitet për votim

Votojmë, tash

Një votim e kemi me dorë dy, tre, katër

- Për..... 56
- Kundër 2 - Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 2 – Votojmë, tash

- Për 57
- Kundër 2 - kundër kalon amendamenti

Amendamenti nr. 3 – Votojmë, tash Me ngritje të dorës dy, tre, katër

- Për 56
- Kundër..... 1 – kalon amendamenti

Amendamenti nr – Votojmë, tash

- Për 55
- Kundër..... 2 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 5 – Votojmë, tash

- Për..... 57
- Kundër..... 1 – kalon amendamenti

Amendamenti 6.

Votojmë, tash

- Për..... 58
- kundër nuk ka

Amendamenti nr. 7

Votojmë, tash

- Për 54
- Kundër..... 1 – kalon amendamenti

Në sallë momentalisht i kemi 63 deputetë

Amendamenti nr. 8

Votojmë, tash

- Për..... 56
- Kundër..... 2 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 6

Votojmë, tash

- Për..... 58
- Kundër..... 1 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 10

Votojmë, tash

- Për.....59
- Kundër..... 1 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 11

Votojmë, tash

- Për58
- Kundër..... 2 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 12

Votojmë, tash

- Për..... 61
- Kundër..... 1 – kalon amendamenti

I lus deputetët që ta votojnë në tërësi Projektligjin bashkë me këto amendamentet e aprovuara tash.

Amendamenti nr. 62

Votojmë, tash

- Për 59
- Kundër..... 2 –aprovohet - miratohet në parim Projektligji në fjalë, vazhdoni amendamentet me i aprovuar

Shkojmë me pikën e pestë të rendit të ditës

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht të gjirit.

Zotërinj ministra, ju lutemi të punojmë.

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë me 1 qershor të këtij viti.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raport me rekomandimet e amendamenteve.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit me qumësht të gjirit e ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit me qumështin e gjirit dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për nxitjen, mbrojtjen dhe të ushqyerit me qumësht të gjirit dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Shkojmë te aprovim i amendamenteve një nga një

Amendamenti nr. 1

Votojmë, tash

- Për..... 57
- Kundër... 1 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 2

Votojmë, tash

- Për 57
- Një 1 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 3

Votojmë, tash

- Për 56
- Kundër 1 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 4

Votojmë, tash

- Për..... 52
- Kundër..... 3 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 5

Votojmë, tash

- Për..... 56

- Kundër..... 3 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 6

Votojmë, tash

- Për..... 52

- Kundër..... 2 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 7

Votojmë, tash

- Për..... 55

- Kundër..... 2 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 8

Votojmë, tash

- Për..... 56

- Kundër 1 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 9

Votojmë, tash

- Për..... 51

- Kundër..... 2 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 10

Votojmë, tash

- Për..... 59

- Kundër..... 2 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 11

Votojmë, tash

- Për..... 58

- Kundër 2 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 12

Votojmë, tash

- Për..... 57
- Kundër..... 2 - kalon amendamenti

Amendamenti 13

Votojmë, tash

- Për 56
- Kundër..... 2 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 14

Votojmë, tash

- Për 54
- Kundër..... 2 – kalon amendamenti

Amendamenti nr 15

Votojmë, tash

- Për..... 55
- Kundër..... 3 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 16 dhe i fundit

Votojmë, tash

- Për 58
- Kundër..... 2 – kalon amendamenti

Shkojmë në aprovimin në parim të Projektligjit bashkë me amendamentet që janë votuar një nga një

Pra provojmë Projektligjin në tërësi

Votojmë, tash

- Për 60
- Kundër 2

Konstatohet se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht të gjirit. Ju faleminderit

GAZMEND MUHAXHERI - Pika e gjashtë e rendit të ditës Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse. Konstatime hyrëse – Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 31 tetor 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Procedimi i mëtejshëm vazhdon si vijon: Ftoj ministrin Sadik Idriz që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

SADIK IDRIZ – Ministër i Shëndetësisë

Predsedavajući, poštovani poslanici pozdravljam otvaranje procedure u Skupštini Kosova za usvajanje Zakona o sprečavanju suzbijanja zaraznih bolesti veoma važnim zakonskom dokumentu o zdravstvenoj nezi građana za zdravstveni sektor Kosova uopšte.

Nacrt zakona za sprečavanje suzbijanje zaraznih bolesti ima za cilj postavljanje zakonske baze u saglasnosti sa nacionalnom politikom i zakonima, međunarodnim preporukama, i u skladu sa zahtevim a koji proizilaze iz ključnih dokumenata Ministarstva zdravstva.

Prema oceni epidemiološkog Odeljenja nacionalnog instituta javnog zdravstva Kosova, 50% slučajeva zaraznih bolesti u posleratnim periodu na Kosovu pripada grupi oboljenja koja se prenose kontaminiranom hranom i vodom. U poslednjih 7 godina registrovano je i izradjeno na desetine lokalnih i masovnih epidemija koje su uzrokovane kontaminiranom hranom, pored toga, u ovom periodu zabeležene su i dve veće epidemije hemoralgične groznice i krimikongoitolaremija kao ove godine meningitis. Od oko 100 hiljada slučajeva zaraznih bolesti 5 vrste pripada grupi, bioterorističkih bolesti, 50% stanovništva Kosova i danas pije nehigijensku vodu a samo 30% je uključeno na vodovodnoj kanalizaciononu mrežu. Takodje prisuti su problemi kao korišćenje sumljivih odnosno kontaminiranih namirnica, visok stepen kontaminiranosti bunara i drugih vodnih izvora, takodje je visok stepen smrti odojčadi, nizak nivo obrazovanja, informisanja i prosvećenosti stanovništva.

Ovaj Zakon, osim ispunjava zakonskog vakuma koji je prouzrokovao neispunjavanje zadataka i obaveza u ovoj oblasti veoma važan i koristan za sve, ali u prvom redu za građane, za zdravlje građana Kosova. Cilj ovog zakona je da obezbedi dovoljan pravni osnov za kreiranje i sprovođenje efikasne politike u oblasti istraživanja, sprečavanje suzbijanja i zaštite stanovništva od zaraznih bolesti koji ugrožavaju cijelu zemlju, te određivanje zdravstvenih i drugih institucija koji moraju izvršavaju obaveze koje proističu iz njega odnosno subjekte koji su nosioci aktivnosti na sprečavanje suzbijanje i iskorenjivanje zaraznih bolesti. Pored opštih zakona ima i ciljevi na način funkcioknisanja epidemiologije zaraznih bolesti, organizaciju rada i podjelu odgovornosti s obzirom na to da Nacionalni institut javnog zdravstva Kosova već funkcioniše integralno sa svim regionalnim institutima u sprovođenju zajedničke strategije zdravstva koje je izradilo Ministrastvo zdavstva. S obzirom da oblast epidemiologije je javnog zdravstva nije bila pravno uređjena kao prioritetno pitanje, nametnula se potreba izrade i donošenje zakona o sprečavanju i suzbijanju zaraznih bolesti. U tom cilju Vlada je formirala radnu grupu koja je pripremila Nacrt ovog zakona čije donošenje predstavlja čvrstu osnovu načina organiziranja i funkcionisanja epidemiologije zaraznih bolesti.

Radna grupa je za izradu Nacrta zakona u toku svoga rada konsultovala i proučila veliki broj zakona i propisa Evropske zajednice i šire koje regulišu javno zdravstvlje u celini, a posebno oblast epidmiologije zaraznih bolesti koji su se u dosadašnjoj praksi pokazali veoma uspešnim u pogledu organizacijae koordinacije i implementacije od interesa za celo kosovsko društvo, prilagodjavajući i konkretnim unutrašnjim uslovma i prilikama.

Dame i gospodo, na kraju želim da Vas pozovem da svojim diskusijama, predlozima i amandanima date svoj doprinos u poboljšanju ovog Nacrt zakona u interesu zdravlja građana Kosova. Hvala vam!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI – Ju faleminderit z. ministër.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputeti Fehmi Vula.

DEPUTAETI FEHMI VULA – Ju faleminderit z. kryesues. Sot para veti e kemi një ligj shumë të rëndësishëm për shëndetin e popullit. Fatkeqësisht duhet të potencojmë se bëhet fjalë për një kohë shumë të vështirë, kohë të cilën për afërsisht duhet ta krahasojmë me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore për shkak të disa fenomeneve të paraqitura në kohë të fundit. Z. ministër e përmendi, e ne e kemi përmendur edhe shumë herë se në Kosovë një numër shumë i madh i regjioneve tona ballafaqohet me ujë të kualitetit shumë të dobët. Uji është njëri prej faktorëve dhe burimeve, që më së tepërmi i përcjell sëmundjet ngjitëse. Kohë pas kohe kemi edhe fenomene të ndryshme të cilat shoqëria në tërësi, Ministria e sidomos mungesa e madhe e mjeteve financiare bëjnë problem. Për me mujtë me u ballafaquar me këto probleme shumë të mëdha të cilat paraqiten kohë pas kohe. Është shumë me rëndësi se niveli i shëndetësisë sidomos i asaj preventive për momentin është mjaft i lartë për arsye se Instituti i Shëndetit Publik me institutet e tjera 7 sosh në Kosovë, është në përgatitje dhe me një staf shumë të mirë përgatitor, por fatkeqësisht se situata shumë shpesh del nga duart dhe duhen përgatitje shumë të mëdha edhe profesionale, por edhe monetare-financiare.

Natyrisht se ligji ka nevojë shumë të madhe për përgatitje, Komisioni funksioni do të punojë shumë seriozisht sikurse deri më tash dhe do të përgatit amendamentet e nevojshme, por ai që është shumë me rëndësi, që sot Grupi Parlamentar i LDK-së do ta mbështesë në parim këtë ligj e mandej fuqishëm do të punojmë në këtë drejtim.

Më vjen keq, duhet të përmendi dhe të potencoj shumë se kohë pas kohe Shërbimit shëndetësor në Kosovë po i duhen mjete shtesë financiare të cilat Qeveria e Kosovës shpesh nuk po i ka. E dinë shumë mirë që gjatë vitit në vijim patëm shumë problem me gripin e shpendëve. Kemi pasur problemin e paraqitjes së mijve etj. etj. etheve hemorragjike, por ajo që është shumë me rëndësi, ne ligjin do ta aprovojmë e kjo punë është shumë e rëndësishme e mandej kohë pas kohe besoj se do t'ia dalim në krye të gjithë së bashku që t'i evitojmë ose t'i zbusim pasojat e sëmundjeve infektive. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI – Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së z. Flora Brovina, le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi

DEPUTETJA FLORA BROVINA – I nderuar kryesues, kolegë dhe kolege, z. ministra Kaherë është pritur një ligj siç është Projektligji për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe luftimin e tyre, madje ky mund të ishte dhe ligji i parë pas aprovimit të Ligjit për shëndetësi, kur dihen rrethanat e jetës në Kosovë dhe kushtet e rënda, kur dihet popullimi i dendur dhe popullata e re, e ndjeshme në infeksionet e shumta që ndodhin. Ligji si ky e shpreh seriozitetin e institucioneve edhe të kuptuarit e politikëbërjes në lëmin e shëndetësisë. Kosova është vend me morbiditetin më të lartë të sëmundjeve ngjitëse e së këndejmi edhe me mortalitetin më të lartë të foshnjave nga sëmundjet

ngjitëse. Me epidemi të shumta dhe me ushqim të kontaminuar siç e tha edhe z. ministër. Me epidemi lokale të herëpashershme gjatë këtyre viteve kemi pasur epidemi që u zunë në gojë edhe nga vendet fqinje dhe më lart, siç është epidemia e etheve hemorragjike, tularemia e të tjera. Në vit regjistruan thuhet mbi 100 mijë raste të sëmundjeve ngjitëse, por nuk dihet sa raste nuk regjistruan. A mund të zvogëlohen sëmundjet ngjitëse me këtë ligj siç është ky, po të aprovohet. Ligji është më se i nevojshëm, si kornizë masash dhe ndëshkimesh, por shfaqja e sëmundjeve ngjitëse është e lidhur ngushtë me kushtet dhe rrethanat e jetës, me standardin dhe me nivelin e arsimit të përgjithshëm, me edukimin shëndetësor dhe sidomos me shkallën e varfërisë. Gjysma e popullatës të Kosovës nuk ka ujë higjienik, madje 70% e popullatës nuk është e kyçur në ujësjellës që do të thotë se populli pi ujë të kontaminuar ose dyshojmë se pi ujë të kontaminuar. Situata më e keqe është sa i përket kyçjes në kanalizim që shpeshherë është burim i infeksionit.

Në Kosovë konsumohet ushqim i kontaminuar dhe jetojmë në një mjedis të kontaminuar, prej këtyre vjen edhe shkalla e lartë e vdekshmërisë nga sëmundjet ngjitëse si një karakteristikë e shoqërisë së varfër dhe jo të zhvilluar.

Për sa i përket shkallës dhe nivelit në jemi një vend që duhet t'i kushtojë shumë rëndësi luftës parandalimit të sëmundjeve ngjitëse. Pjesë, cila është shkalla e imunizimit të popullatës në këtë aspekt pasi që profilaksa është më e rëndësishmja. A po sigurohen vaksina të mjaftueshme dhe të çfarë kualiteti janë ato? A po kontrollohet ky kualitet. Vaksinat a janë të obliguara nga ana e ministrisë apo po i paguajnë qytetarët. Obligimi i Ministrisë për sigurimin e vaksinave duhet theksuar dhe precizuar edhe në këtë projektligj, sidomos kur dihet se popullata jonë në mungesë të vaksinave po e zëmë të gripit shpeshherë udhëton edhe në vendet fqinje dhe i bart ato në duar përtej kufijve e dihet se vaksina në dorën e qytetarit është shumë e rrezikshme, madje e rrezikshme edhe për përhapjen e vet sëmundjes. Sa i përket projektligjit, mendoj se është mjaft i detajizuar dhe i qartë. Rrallë kemi pasur ndonjë projektligj të ngjashëm. Autorët e këtij projektligji megjithatë pranojnë se ata janë bazuar në modelin sloven të një projektligji të tillë. Kjo dhe është e meta evidente e këtij projektligji, sepse në një mënyrë ai e kopjon ligjin sloven. Sllovenia nuk i ka pasur dhe as që i ka karakteristikat demografike, epidemiologjike dhe as që ka standardin dhe problemet që e ndjekin Kosovën. Madje mendoj se këto çështje duhet qartësuar, në ligj duhet qartësuar qëllimin pse nxirret ligji dhe arsyeshmërinë. Për ne janë shumë më të mëdha se sa që mund t'i ketë Sllovenia.

Vërejtjet tjera janë: se ligji nuk vë theks të mjaftueshëm edhe në pjesët e tjera të mjekësisë siç është Instituti Kombëtar i Mjekësisë, i cili ka ofruar dhe kryesisht përbën grupin punues për këtë projektligj. E them këtë, sepse kujtoj se rëndësi më pak i është kushtuar mjekësisë primare dhe sidomos pediaterve dhe mjekëve infektologë, të cilët i qasen problemit në plan të parë, pasi ata takohen së pari me të sëmurët infektivë. Ata kanë mundësi të ofrojnë jo vetëm ta zbulojnë sëmundjen, por edhe ta parandalojnë, të luftojnë sëmundjen dhe të merren me edukimin, me masat preventive siç është imunizimi.

Projektligji gjithashtu nuk përmend edhe infeksione të shumta interhospitalore që ndonjëherë mund të shfaqen si epidemi lokale brenda institucioneve shëndetësore. Ndoshta kjo dukuri nuk është shumë e njohur për Kosovën, por ajo me të madhe luftohet në vendet e zhvilluara dhe gjithandej. Ndërsa, në anën tjetër Kosova dhe institucionet e shëndetësisë spitalet e klinikat tona kanë më shumë kushte të

zhvillojnë infeksione brenda d.m.th. interhospitalore , për shkak të kushteve të pavolitshme të punës të ,mungesës së mjeteve higjienike dhe të tjera, por edhe të numrit të madh të të sëmurëve.

Pasur i veçantë kujtoj se janë mbikëqyrja shëndetësore prodhimi e qarkullimi i artikujve ushqimor edhe roli i inspekcioneve sanitare. Kjo sjell edhe një herë para nevojën e miratimit të Ligjit për ushqim dhe agjencioneve të pavarura ndërmëtorë ,i cili, si i tillë, nuk është propozuar as në buxhetin e Kosovës , sepse ai parashihet të jetë në kuadër të Ministrisë të Shëndetësisë dhe se ky agjencion ,pra është jashtëzakonisht i rëndësishëm për shëndetin e popullatës dhe duhet t'i kushtojmë një rëndësi të veçantë dhe ai duhet të jetë i pavarur.

Çështja e inspekcioneve është rregulluar me ligj të veçantë dhe në këtë Projektligj nuk ka pasur nevojë të hyhet në aq shumë detale, këto sigurisht do të korrigjohen gjatë amendamentimit.

Dispozita ndëshkimore gjithashtu parasheh ndëshkimet që janë paraparë edhe në Ligjin për shëndetësinë, por të kujtojmë vetëm rastin e infektimit me virusin e sidës nga neglizhenca ose nuk mund të besoj se ka qenë e qëllimshme të punëtorëve shëndetësorë vulgarë në një vend afrikan dhe dënimi drastik i tyre, prandaj kujtoj se edhe sa u përket dënimeve dhe sëmundjeve ngjithëse duhet të jemi edhe më të ashpër. Ky projektligj përkrahet nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI- Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka Zylfije Hundozi, le të përgatitet deputetja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Z. kryesues, z. ministra, kolegë deputetë.

Me zhvillimin e shkencës së mjekësisë në botë dukej se numri i sëmundjeve ngjithëse po zvogëlohet e disa prej tyre,që shkaktojnë vdekjen e mijëra njerëzve në dy shekujt e fundit, tanimë janë zhdukur fare. Lufta më e gjatë ka qenë kundër tuberkulozit, i cili edhe në shtetet më të zhvilluara siç janë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës , kur është menduar se është zhdukur plotësisht, në vitet e fundit është paraqitur prapë. Një moskujdes në parandalimin e tyre me anë të vaksinimit mund të shkaktojë paraqitjen e tyre, e çka është më e keqe se sëmundjet infektive ekzistojnë rreziku që ato të përfshijnë një numër të madh të njerëzve,gjegjësisht të shfaqen epidemi. Rregullimi i kësaj fushe me anë të ligjit është veprim i qëlluar i Ministrisë së Shëndetësisë dhe unë i përgëzoj për këtë. Në punën e këtij ligji janë përfshirë një grup i madh i ekspertëve kosovarë me përvojë të konsiderueshme në këtë lëmi, të cilët i kanë përfshirë në ligj të gjitha veprimet për parandalimin e sëmundjeve ngjithëse. Ligji është i qartë, i ndarë në kapituj të cilët edhe më tepër e thjeshtësojnë dhe i mundësojnë këtij ligji të aprovohet lehtë në praktikë. Gjithashtu, me këtë ligj janë diferencuar qartë përgjegjësitë të cilat do t'i ketë Ministria, e të cilat Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik. që do t'i mënjanonte keqkuptimet dhe humbjen e kohës për veprim me rastin e shfaqjes të ndonjë epidemie .siç është rasti në kohën e rrezikut potencial nga gripi i shpezëve kur Instituti i Shëndetit Kombëtar nuk ishte përfshirë në shtabin për kriza.

Pasi që nuk ka ligj të përkryer, unë i kam disa vërejtje në kapitullin të dënimeve, gjegjësisht të gjobat.

Në nenin 55, thuhet se do të dënohet me gjobë prej 25 deri 1000 € për kundërvajtjet .Personi i cili refuzon të hospitalizohet dhe të izolohehet në institucionin shëndetësor kur është i sëmurë ose kur dyshohet se është i sëmur nga sëmundja e caktuar ngjitëse. Mendoj se këtu nuk ka vend për dënim me gjobë, nëse dihet se sëmundjet ngjitëse përhapen shpejt, me rrugë të ndryshme, në shumë njerëz, për- njëherë ,atëherë masat duhet të jenë më të rrepta që të mos i jepet mundësia personit që ta përhapë sëmundjen te personat e tjerë dhe të shkaktojë epidemi me pasoja të paparashikueshme. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj dhe ne do ta japim kontributin tonë në Komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI- Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Reformiste ORA e ka fjalën deputetja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, le të përgatitet deputetja Shpresa Murati.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKLU – Ju faleminderit z. kryesues

KRYESUESI – Janë vetëm dy deputete dhe e kishim përfunduar, po

VAZHDIM i diskutimit të deputetes Fatmire - Mirë atëherë kështu edhe Grupi Parlamentar i Partisë Reformiste ORA e përshëndet nxjerrjen e këtij ligji dhe ne theksojmë se sipas rëndësisë së vet, ky ligj është dashur të jetë ligji i dytë , i cili është dashur të nxirret nga Ministria e Shëndetësisë menjëherë pas Ligjit për shëndetësi.

Meqenëse problematika e sëmundjeve ngjitëse është aq shumë e theksuar në Kosovë, unë e kisha theksuar vetëm nëse e përmendim çështjen e ujit dhe sa është shqetësues fakti se këtu shkruan 50% e popullatës. Unë menjëherë kisha thënë se shumë më sigurt që 60% e popullatës pi ujë johigjienik dhe është momenti i fundit që kjo qeveri dhe tërë shoqëria kosovare të brengoset për këtë çështje dhe ta krijojë një strategji edhe afatshkurtër dhe afatgjatë të daljes nga kjo situatë, sepse ne me një qasje të tillë ,siç e kemi tani, nuk mund të dalim nga kjo situatë ku udhëheqim me numër kaq të madh të sëmundjeve ngjitëse dhe kjo duhet të jetë prioritet i kësaj qeverie.

Ajo që rregullon ky ligj më në fund është obligimi i paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse. Si punëtore e shëndetësisë publike e di problemin e madh në paraqitjen e sëmundjeve ngjitëse, sepse mjekët ende nuk e shohin si obligim ta bëjnë këtë dhe ne ende nuk e kemi shifrën e vërtetë të sëmundjeve ngjitëse dhe mund t'ju siguroj se është më e madhe se ajo që është paraqitur këtu për shkak të mos raportimit korrekt shpeshherë edhe raportimit zero.

Tjetër, ky ligj është shumë i kushtueshëm, është e qartë dhe nuk i takon vetëm Ministrisë së Shëndetësisë realizimi i tij. Ky ligj i takon tërë Qeverisë, sepse këtu janë problemet multisektoriale dhe Qeveria duhet të mendojë në këtë drejtim, sepse këtu për realizimin e këtij ligji shpesh kërkohet buxhet emergjent.

Luftimi i epidemive nuk mund të parashihet me një buxhet ekzistues se ajo u pa edhe tek epidemia e meningjitit që aq shumë e përfolur dhe fatmirësisht prej Zotit na erdh në formë shumë të lehtë, jo që kemi qasje të organizuar dhe e luftuam me sukses, sepse fillimisht kemi qenë shumë të dezorientuar me mungesë të madhe të barërave nga lista

esenciale, mirëpo fatmirësisht me minimizimin e rasteve fillimisht më vonë janë siguruar mjetet dhe dolën shifrat reale.

Do të thotë shumë mirë duhet të mendojmë po qe se na paraqitet ndonjë epidemi tjetër e gripi i shpezëve mund të them është problem global, ku ne edhe ashtu nuk kemi fuqi më të madhe të bëjmë diçka në mënyrë vetanake, por epidemitë siç janë meningjiti, ethet hemorragjike, krime kongo që tash janë bërë diçka e zakonshme edhe për Kosovën, ne duhet të mendojmë mirë për një buxhet të siguruar emergjent për këto raste.

Gjithashtu, çështja e Inspektoratit sanitar. Në fund e kisha theksuar edhe një herë dhe e lus këtë kuvend për një vëmendje të madhe edhe pse e di se çështjet si Ligji për sëmundje ngjitëse nuk janë shumë interesant. Në bazë të reagimeve në përgjithësi këtu, por ta keni të qartë se është problem shumë i madh për Kosovën, ndoshta ndër problemet më të mëdha në sferën e shëndetësisë, që e prek çdo qytetar të Kosovës.

Të mendojmë mirë, nëse e përmendim inspektoratin sanitar, çdokush që e ka lexuar këtë ligj e sheh rëndësinë e veçantë të inspektoratit sanitar, përveç institucioneve, siç janë: Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, do të thotë së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe me institucionet e nivelit sekondar dhe primar.

Rëndësia e veçantë e inspektoratit sanitar tregon edhe një herë një qasje totale joserioze në hartimin e Ligjit për ushqim, ku tentohet që ky inspektorat të amputohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe të kalojë nën ingjirencat e Ministrisë së Bujqësisë, që është e tolerueshme. Ne e kemi marrë edhe pajtimin e ministrit të Shëndetësisë, pas dëgjimit publik, që ky inspektorat mund të kalojë vetëm në një agjension, i cili në rastin më të mirë do t'i përgjigjet direkt bordi të kryeministrit dhe të jetë nën ingjirencat e Qeverisë, jo të kalojë direkt në një inspektorat në një ministri, siç është Ministria e Bujqësisë..sepse inspektorati sanitar nuk ka të bëjë vetëm me ushqim, por këtu po e shohin spektrin e problemeve të cilat reflektohen në numrin kaq të madh të sëmundjeve ngjitëse.

Edhe një herë po e theksoj, problemi është multisektorial. Shumë ministri këtu implikohen se e kemi mënjanimin e ujërave të ndotura dhe të hedhurinave dhe shumë e shumë kushte që duhet të sigurohen dhe kanë implikime në ministrinë e tjera. Problemit multisektorial duhet t'i qaset tërë Qeveria.

Edhe një herë e përsëritem nxjerrjen e këtij projektligji dhe kontributin tonë do ta japim bashkë me ekspertët, të cilët kanë punuar në grupin punues gjatë amendamentimit në Komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI –Ju faleminderit – Falën e ka në emër të Grupit 6+ deputetja Shpresa Murati

DEPUTETJA SHPRESA MURATI –Hvala gospodine predsedavajući pozdravljam sve prisutne.

Nacrt zakona o sprečavanju i suzbijanju zaraznih bolesti je jedan od veoma važnih zakona koji uređuje ovu oblast.

Cilj ovog Nacrta zakona je da oabezbedi povoljan pravni osnov za kreiranje i sprovođenje efikasne politike u oblasti istraživanja, sprečavanja, suzbijanja i zaštite stanovništva od zaraznih bolesti, kao i iskorenjavanje zaraznih bolesti. Epidemiološki podaci koji su ovde istaknuti da većina stanovništva koristi nehigijensku pijaču vodu, da koristi kontaminirane životne namirnice, da je visok stepen kontaminiranosti bunara

i uopšte životne sredine, nizak nivo obrazovanja, informisanje i zdravstveni prospečivanja ukazuju na neophodnost donošenja ovog zakona Zakon o sprečavanju zaštiti suzbijanju zaraznih bolesti.

Iz člana 3. Nacrta zakona može se videti da je lista zaraznih bolesti zaista široka pa je u vanrednim epidemijskim prilikama potrebno obezbediti velike količine vakcina i lekova. Prema član 49. ovog Nacrta zakona u cilju zaštite stanovništva od zaraznih bolesti, Vlada Kosova obezbedjuje materijalna sredstva za hitne slučajeve.

Radi se znači o jednom Nacrtu zakona koji je zaista sveobuhvatan, koji detaljno reguliše pitanje iz ove oblasti pa ga Parlamentarna grupa 6+ u načelu podržava i verujem da će Funkcionalna komisija uraditi sve da dobijemo zakon koji će biti sprovodljiv u praksi. Hvala!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI- Thërras deputetët të vijnë në sallë dhe të përgatitemi për votim.

Në mungesë të kuorumit jap pauzë deri në orën 12:00, kështu që gratë parlamentare pres ta përfundojnë takimin që e kanë dhe të kthehen ta votojnë ligjin. Ju faleminderit!

Seanca plenare pjesa e II-të dt. 22.12.2006.

Deputetë të nderuar!

Ju lus të përgatiteni dhe të deklarohemi për miratimin në parim të këtij projektligji.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Në sallë janë 66 deputetë

Vazhdojmë me përgatitjet për votim. Lus edhe një herë regjinë le të përgatitet për votim.

Votojmë tash:

PËR	62
KUNDËR.....	0
ABSTENIM.....	-

Me 62 vota për miratohet projektligji.

Në bazë të Rregullores së punës, neni 23. pika 6 dhe rregullës 35 pika 2. Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe referues,
- Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj, nga shqyrtimi i parë, të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin, raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën shtatë të rendit të ditës

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimin e ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve me 24 nëntor 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin Ibrahim Selmanaj që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantoj Projektligjin.
Ministër foltorja është e juaja.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ – Ju faleminderit zotëri kryesues, të nderuar deputetë, kolegë ministra,

Inspektimi i vendeve të punës në kuptimin e kontrollit të kushteve në punë, tek punëdhënësit në fushëveprim, me interes të veçantë, është i rregulluar me Rregulloren nr. 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë.

Dispozita këto të cilat janë në përputhje të plotë me konventën ndërkombëtare nr. 81, për Inspektimin e punës, dhe rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës ILO-së.

Sot para jush gjendet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin e punës, sponsor i të cilit është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ekspozoja ime ka për objektive të ofroj shpjegime të nevojshme lidhur me propozimin e Projektligjit të lartpërmendur.

Aktualisht në Kosovë është në fuqi Ligji për inspektoratin e punës nr. 2002/9, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19.12.2002 dhe i nënshkruar më 21.02.2003, nga përfaqësuesit special i sekretarit të përhershëm. Në këtë ligj është themeluar Agjensioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, si organ ekzekutiv, i cili mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të Rregullores nr. 2001/27 për ligjin themelor të punës në Kosovë dhe dispozitat tjera të aplikueshme nga fushat e punësimit.

Fushëveprimi i Agjencionit ekzekutiv të inspektoratit të punës është: sigurimi i zbatimit, në mënyrë unike, për të gjitha vendet e punës i dispozitave të Rregullores nr. 2001/27 për ligjin themelor të punës në Kosovë dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit që kanë të bëjnë me kushtet në vendin e punës, orarin e punës, pagat, sigurinë dhe shëndetin, mosdiskriminimin e të punësuarve etj.

Të nderuar deputetë!

Mendojmë se me ndryshimet dhe plotësimet e ligjit nr. 2002/9, për Inspektoratin e punës në Kosovë, veprimet dhe aktivitetet e Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, në mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Rregullores, nr. 2001/27, për Ligjin themelor në

punë, në Kosovë dhe dispozitave të tjera të aplikueshme në fushën e punësimit në tërësi do të jenë më efikase, funksionale dhe racionale.

Me këto plotësime dhe ndryshime, të këtij ligji janë eliminuar paqartësitë, në rolin e ushtrimit të kompetencave dhe të përgjegjësive që kanë personeli, duke u nisur prej kryeshefit të Agjensionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, të zëvendësve të tij (për çështje juridike, siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës si dhe për çështje shëndetësore) dhe inspektorëve të punës në anën tjetër, ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji, do të ndikojnë pozitivisht edhe me rritjen e bashkëpunimit dhe të sinkronizimit të punëve dhe detyrave të punës, me Qeverinë komunale, inspektoratet tjera, me autoritetet tjera relevante dhe me Shërbimin Policor të Kosovës.

Të nderuar deputetë!

Me zbatimin e drejtë dhe efikas të dispozitave të propozuara në Projektligjin e përmendur, sigurisht se Agjensioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës do të realizojë objektivat e përcaktuara në dokumentet programore afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata.

Ndryshimet dhe plotësimet në përmbajtjen e Ligjit për Inspektoratin e Punës, konsistojnë në:

- Përcaktimin e drejtë të fushëveprimit të Agjensionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës,
- Qartësimin dhe konkretizimin e funksioneve të Agjensionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës,
- Rregullimin dhe përcaktimin e përbërjes në mënyrat e emërimit të stafit drejtues të Agjensionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës,
- Definimin dhe përcaktimin e autorizimeve për kryeshefin e Agjensionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, definimin dhe përcaktimin e autorizimeve për kryeshefin e Agjensionit ekzekutiv të inspektoratit të punës, të zëvendësve të tij dhe të inspektorëve të punës.
- Rregullimin dhe qartësimin e procedurave administrative të ankimit, në përputhje me Ligjin për procedurat administrative dhe legjislacionin tjetër të aplikueshëm,
- Ndryshime dhe plotësime e tjera të karakterit teknik dhe administrativ.

Të nderuar deputetë!,

Ndryshimet dhe plotësimet në këtë ligj nuk paraqesin implikime buxhetore, sepse ekzistojnë resurset njerëzore dhe buxheti për funksionimin e këtij organi ekzekutiv. Përkundrazi me miratimin e këtyre plotësimeve dhe ndryshimeve në këtë ligj krijohen kushte të favorshme për krijimin e të hyrave për buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Të nderuar deputetë!

Duke e çmuar kohën tuaj ju falënderoj për vëmendje dhe kujdesin tuaj me shpresë së gjatë shqyrtimit të këtij Projektligji me qasjen dhe angazhimin tuaj do të ndihmoni në

avancimin e tij. Pra, në këtë mënyrë do të jepni kontributin tuaj të cilin e vlerësojmë dhe që njëkohësisht është shumë i vlefshëm e me interes të veçantë për rregullimin e raporteve në mes të punëdhënësve dhe punëmarrësve në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHERI - Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka fjalën deputeti Ilaz Pireva, le të përgatitet deputetja Flora Brovina.

DEPUTETI ILAZ PIREVA – Zotëri kryesues, të nderuar deputetë,
Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, të paraqes fjalën në lidhje me miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, të inspektoratit të punës.

Siç dihet nga ky Kuvend në vitin 2002, është miratuar ligji i inspektoratit të punës, por që arsyet për ndryshimin e tyre, janë dhënë në shpjegimin nga sponsoruesi i këtij ligji. Ndryshim thelbësor i këtyre ndryshimeve është, themelimi i agjensionit ekzekutiv, të inspektoratit të punës dhe ky ndryshim ka mbështetje në kapitullin e 12, në nenin 114, të Ligjit të punës, i cili është në procedim e sipër.

Edhe pse thuhet që ky ligj nuk do të ketë implikime buxhetore, megjithatë krijimi i agjensionit, është një çështje që kërkon edhe mjete. Mirëpo arsyetimi jepet se gjoja me funksionimin e këtij ligji dhe të nën-ligjeve të tjera, të cilat do t'i nxjerrë Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, do të mbulohej këto shpenzime për 70 punonjës, sa i ka deri më tani. Në punën që do të bëjë Komisioni funksional, të gjitha çështjet e tjera do të shqyrtohen .Pra, nga ky komision edhe një herë po përsëris, e mbështesim në parim miratimin e këtij ligji në lexim të parë. Ju faleminderit!

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit,
Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e ka fjalën deputetja Flora Brovina, le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi.

DEPUTETJA FLORA BROVINA – Ligji për inspektionin e punës është ndër ligjet e para të aprovuara në Parlament. Në mandatin e parë është aprovuar dhe sigurisht, që ky ligj ka pasur mjaft të meta edhe atëherë kur është aprovuar, Komisioni për Punë dhe Mirëqenie Sociale e patë shprehur dilemën se a meriton ky ligj të procedohet më tutje dhe të aprovohet, sepse, ishte ligj shumë i dobët, por ishte insistimi i Ministrisë së Mirëqenies Sociale, se ky ligj, është i domosdoshëm dhe i një rëndësie të veçantë. Prandaj, me gjithë amendamentimin mendoj se ky ligj nuk është i mirë ,por a është momenti pikërisht tani të ndryshohet, kur në procedurë ne kemi ligjin e punës, një ligj bazik për këtë lëmi, ligj i cili sigurisht rregullon edhe çështjen e inspektionit të punës.

Pa u aprovuar ligji për punën, që ka qenë insistim i grupit tonë parlamentar në funksion të Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, nuk mund të procedojmë ligjet e tjera bazike dhe ndryshime të tjera në ligje, sepse duhet të amendamentojmë ligjin bazik, pra ligjin e punës.

Nëse e shohim se çfarë janë ndryshimet, pajtohem me kolegun parafolës, se ndryshimi i vetëm këtu qëndron tek Agjensioni Ekzekutiv i cili nga autoriteti shndërrohet pra, në agjension dhe në funksionalizimin dhe konkretizimin e detyrave të tij, të stafit, të zëvendësve të udhëheqësve të këtij agjensioni dhe të stafit që do të angazhohet aty.

Natyrisht edhe pse thuhet se ky projektligj nuk ka implikime buxhetore, parashihet shuma prej 1 milion e 99 mijë €. Agjensioni në të vërtetë është autoriteti i inspektionit të punës. Arsyetimi se Agjensioni për Integritet Evropian ka dhënë lejen nuk është i mjaftueshëm, sepse edhe për Ligjin për inspektionin e punës, ky agjension e patë dhënë lejen, se është kompatibil me ligjet evropiane. Ai nuk ka fol në detaje, por vetëm këtë mendim e jep, e besoj që ky Projektligj mund të pret ligjin bazik, ligjin e punës, i cili është në procedurë të amendamentimit, nuk është ndonjë kohëzgjatje shumë e madhe dhe mund të votojmë pastaj. Pra, mendoj se nuk duhet votuar.

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHIRI - Ju faleminderit,

Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën deputetja Zylfiye Hundozi, le të përgatitet deputetja Fatmire Mulhaxha Kollçaku,

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Zoti kryesues, zotërinj ministra, kolegë deputetë!

Nëse një ligj nuk mund të zbatohet në praktikë, atëherë pushon arsyeja për ekzistimin e tij, prandaj nëse ky ndryshim dhe plotësim do ta bëjë Ligjin e ardhshëm të zbatueshëm në praktikë, Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrah miratimin e këtij projektligji në parim edhe ne do ta japim kontributin tonë, në Komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHIRI - Ju faleminderit,

Në emër të Partisë Reformiste ORA, ka fjalën deputetja Fatmire Mulhaxha Kollçaku, le të përgatitet deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU – Ju faleminderit zotëri kryesues, Grupi Parlamentar i Partisë Reformiste ORA e dimë se do të ketë nevojë për amendamentimin e këtij ligji, mirëpo ne në parim mendojmë që fillimisht duhet të kryhet amendamentimi i ligjit bazik ,që është Ligji i punës dhe tek atëherë duhet të mendojmë për ndërrime dhe ligje të tjera, të cilat gjithsesi duhet të kenë implikime buxhetore. U tha edhe nga parafolësit se formimi i një agjensioni kurrsesi nuk mund të jetë pa implikime buxhetore, d.m.th. detyrë parësore e këtij Kuvendi është që ta kryejë punën e amendamentimit të ligjit bazik që është Ligji i punës, pasi të kalojë në shqyrtim të dytë këtu, tek atëherë mendojmë se është koha të sjellim një ligj ,siç është ky, të bëjmë ndërrimet në ligjin për inspektoratin e punës. kështu që për momentin ne mendojmë pa e krye amendamentimin , bëjmë prejudikime. Ky duhet ti përshtatet Ligjit të punës pas amendamentimeve, jo formës siç e ka sjellë Ministria. Duhet ta kemi një rregull në punën tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit,

Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputetja Zahrije Jusufi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryesues, të nderuar ministra prezent, kolegë deputetë!

Kam shqyrtuar me vëmendje të madhe dhe më lejoni të konsideroj se kam një paranojë të kësaj çështjeje dhe duhet ta përkrah arsyeshmërinë që paraqiti ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale për plotësimin e këtij propozim-ligji, për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit të inspeksionit. Vlerësoj se për ndryshime dhe plotësime ka arsyeshmëri, sepse inspeksioni i punës nuk mund të lidhet me bazueshmërinë si u tentua të thuhet me Ligjin mbi punën, edhe pse jo një sferë, që lidhen shumë mes veti. Ligji i punës ka kaluar shqyrtimin e parë, ndërsa këtu është plotësim ndryshimi i ligjit të inspektoratit, i cili jo vetëm se duhet t'i ketë arsyeshmërinë e plotësimit –ndryshimit, por është imediatet që sa më shpejt edhe këto plotësim-ndryshime, të aprovohen, po që se duam që vërtet të funksionalizohet ligji ekzistues, i cili me të metat që ka nuk u jep inspektorëve mundësi.

Nuk është këtu kryesore edhe krijimi i agjencisë, sepse agjencia si e tillë, është paraparë edhe në Ligjin e punës dhe si e tillë ajo funksionon dhe nuk ka të bëjë me implikime të larta buxhetore, se stafi apo kuadri që kryejnë këto shërbime, me interes shumë të madh, në sferën e padrejtësive shumë të mëdha është i kufizuar në veprim dhe pikërisht ky kufizim i veprimit ka kushtëzuar të paraqiten arsyeshmëria dhe nevoja për plotësim-ndryshim të ligjit ekzistues mbi inspeksionin. Mendoj se masat që duhet ndërmarrë, janë pikërisht ato, sepse tani do të shtohet kontrollimi i marrëdhënies së punës, i cili të gjithëve na është i njohur se si bëhet dhe në ç'mënyrë realizohet, pastaj kushtet e punës, orari i punës, masat e tjera diskriminuese si dhe masat mbrojtëse. Në të thuhet se nëse këto ndryshime dhe plotësime nuk aprovohen, inspektorët e punës do të jenë duarlidhur pa mundësi për ta respektuar në të ardhmen edhe Ligjin e punës në tërësi, jo vetëm pse përkrahet parimisht.

Natyrisht se unë do të paraqes edhe disa amendamente fuqizuese t' them ashtu apo, plotësuese që kanë të bëjnë pikërisht me funksionin e inspektorit të punës dhe me këtë propozim-ndryshim, do të diferencohen në -kuptimin pozitiv, punët, detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorëve në terren, ngase atje bëhen shkeljet më të mëdha të punës dhe çdo vonesë e mospranimit, apo e shtyrjes eventuale të amendamentimit, gjegjësisht plotësim-ndryshimit të këtij ligji, për vlerësimin tim do të kishte shprehje negative dhe pamundësi eliminimi të diskriminimit, në punë dhe në veçanti në sektorin privat ,duke mos përjashtuar edhe atë publik dhe forma të tjera të organizimit të punës.

Edhe një herë shpreh mendimin tim se vërtet duhet përkrahur dhe duhet aprovuar në shqyrtimin e parë, me mundësitë që sipas kapaciteteve, natyrisht profesionale dhe të amendamentohet. Ju faleminderit!

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit,
Ka fjalën deputetja Zahrije Jusufi,

DEPUTETJA ZAHRIJE JUSUFI – I nderuari z.kryesues, të nderuar ministra dhe deputetë!

Ligji për inspektoratin e punës u miratua më 19 dhjetor 2002 dhe është ndër ligjet e para të miratuara nga Kuvendi. Ndërkaq Ligji i punës, 4 vjet më vonë, u miratua në shqyrtim të parë, nga Kuvendi në nëntor të këtij viti. Në memorandumin shpjegues, të Projektligjit

për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës, shpjegohet se mekanizmat janë mbikëqyrës të zbatimit të ligjit, kanë vlerësuar se ekzistojnë pengesa, për zbatimin efikas dhe të drejtë të Ligjit të inspektoratit të punës dhe se qëllimi themelor i Projektligjit është eliminimi i dispozitave kontradiktore dhe të paqarta, të cilat ndikojnë në pamundësinë e zbatimit efikas të ligjit.

I kuptojmë nismën e Agjensionit Ekzekutiv, të inspektoratit për zbatim efikas të mbikëqyrjes nga inspektorët e punës dhe pamundësinë e shqiptimit të masave ndëshkimore ndaj punëmarrësve dhe punëdhënësve. Dhe se inspektorët janë përgjegjës për zbatim efikas dhe të drejtë të ligjit, por nga fusha e punësimit ne kemi në shqyrtim në Komisionin për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale ligjin bazik të punës, i cili është shumë i vonuar. Struktura përmbajtësore e projektligjit është e përafërt me tekstin e ligjit për inspektoratin e punës dhe se teksti i spastruar i ligjit do të ketë dy nene më shumë se nenet e mëparshme. Ndryshimet konsistojnë në konkretizimin e funksioneve të agjensionit ekzekutiv, të inspektoratit të punës dhe inspektorëve të punës. Ndërkaq, në Projektligjin e punës, nenin 115, mbi mbikëqyrjen thuhet se në rastin kur inspektori konstaton se punëdhënësi ka shkelur dispozitat e këtij ligji, do të shqyrtohen këtu e këtu, sanksionet duhet të harmonizohen.

Me nenin 123, me hyrje në fuqi të ligjit të punës, shfuqizohet Rregullorja 2001/27 për Ligjin themelor të punës dhe të gjitha dispozitat e ligjeve në fuqi, që janë në kundërshtim me të. Ndërsa në nenin 1, ndryshohet vetëm fjala autoritet, në agjension, ekzekutiv dhe fjala kryeinspektor zëvendësohet me fjalën kryeshef, disa neneve u ndërrohet vendi, ndërkaq neni 6, i Projektligjit është i njëjtë për të gjitha projektligjet. Mendoj se edhe dispozitat e nenit 118, të Ligjit të punës duhet të harmonizohen, në mënyrë që legjislacioni në fushë të punësimit të jetë i aplikueshëm. Meqë qëllimi themelor i Ligjit të punës janë mbrojtja themelore e të drejtave të punëtorëve, ndalimi i punës së detyrueshme, ndërkaq, inspektori i punës, është përgjegjës për fuqizim të standardeve të punës dhe për të bërë mbikëqyrje më efektive, duhet të harmonizohen dispozitat . Meqë Rregullorja në fuqi mbi Ligjin themelor të punës, do të shfuqizohet pas miratimit të Ligjit të punës, mendoj se problemet që shqyrton Projektligji mund të përmirësohen me rregullore, Apo ndoshta, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, e ka paraparë, se Projektligji për punë nuk do të implementohet, për një periudhë të gjatë kohore, për shkak të mos përllogaritjes reale, të implikimeve buxhetore nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, propozojmë që shqyrtimi i projektligjit, të shtyhet pas shqyrtimit të Projektligjit të punës, dhe harmonizimin me të. Ju faleminderit!

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit,
Fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi,

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – Ju faleminderit, i nderuari kryesues, të nderuar deputetë dhe ku kabineti qeveritar,
Unë e shoh këtu insistimin e koalicionit qeverisës, që plotësimi dhe ndryshimi i këtij ligji të jetë në kuptimin e asaj se sa është dhe çfarë fushe të rëndësishme rregullon ky

projektligj. Jam të dakord, mirëpo në kuptimin logjik, assesi nuk mund të pajtohem. Ne kemi disa rregullore me të cilat deri sot rregullohet marrëdhënia e punës, mirëpo, të gjitha këto rregullore kanë zbrazëtira juridike, kanë kundërshtime në mes veti. Unë nuk e di se çka do të marrë për bazë inspektorati i punës gjatë kontrolleve të veta që do ti kryejë lidhur me krijimin apo me themelimin e marrëdhënies së punës dhe zbatimin e ligjeve, deri sa nuk ka një ligj bazik, i cili shfuqizon ligjet e tjera dhe në mënyrë kronike e rregullon këtë lëmi.

Ne kemi pasur edhe një paralajmërim, pikërisht për ligjin bazikë të punës, nga Fondi Monetar se hynë në grupin e ligjeve që duhet të shtyhet për shkak të ndikimeve të mëdha buxhetore dhe nuk mund të implementohet. Pra, e kemi një fakt tjetër, se në projektbuxhetin e vitit 2007, nuk parashihen implikimet buxhetore, gjegjësisht nuk ndahen mjete për zbatimin e këtij ligji në praktikë.

d.m.th. në Ministria e Mirëqenies, në këtë rast ka shkaktuar konfuzitet në punën e vet dhe si duket nuk i ka harmonizua mirë prioritetet edhe në planifikimin e buxhetit, po edhe në planifikimin e projektligjeve, se cilat duhet të ecin dhe sa duhet ta plotësojnë ato njëra tjetrën pastaj..

Insistimi që të aprovohen ndryshimet dhe plotësimet, e Projektligjit për inspektoratin e punës, po e përsëris edhe një herë jam në dakord. Mirëpo, në këtë formë po qe se ecë ky projektligj sot në parim dhe vazhdohet me amendamentimitn e tij dhe hynë në fuqi, do të lenë mundësinë e shumë interpretimeve që edhe ata inspektorë të punës të përdorin këtë apo atë rregullore, këtë apo atë nen, që në mungesë të ligjit bazik, do të vijnë edhe deri te përfundimet, mbi bazat qoftë politike, qoftë partiake, qoftë shoqërore kolegjiale apo grupore, varësisht nga interesi të cilin e kanë. Ne jemi mësuar se si punojnë inspeksionet deri tash, jemi mësuar se si bëhen kontrollet deri tash. Andaj, kisha kërkua, jo vetëm që të bëjmë insistim të aprovojmë ligje, në atë se të shtohen numri i ligjeve të aprovuara, në listën e ligjeve të cilat janë në fuqi në Kosovë. Po të shohim në mënyrë logjike, kronologjinë dhe lidhshmërinë e tyre. Pa ligjin bazikë, nuk mund të funksionoj si duhet një inspektorat. Jo vetëm ky i punës, po edhe gjitha inspektoratet e tjera të cilat janë sot të themeluara. Ju faleminderit!

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit,

Lus deputetët që të përgatiten dhe të deklarohen për miratimin në parim të Projektligjit për inspektoratin e punës. Lus regjinë që të përgatitet për votim. Votojmë tash:
Në sallë janë të pranishëm 69 deputetë.

PËR.....41
KUNDËR.....25
ABSTENIM.....-

Konstatohet se Projektligji është miratuar në parim dhe në bazë të rregullës 23. pika 6 dhe rregullës 35. pika 2, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe referues,

2. Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afat jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë të shqyrtojë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën e 8 të rendit të ditës

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/4 për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik,

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 29 nëntor 2006. dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj zëvendësministrin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, zotin Behxhet Brajshori, ta paraqes

ZËVENDËSMINISTRI BEHXHET BRAJSHORI – I nderuari kryesues, të nderuar ministra, kolegë deputetë!

Sot për shqyrtim dhe miratim, në parim është Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, nr. 2003/4, për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim.

Ky ligj definon kushtet, procedurat, si dhe përcakton të drejtat dhe detyrat për palët që marrin pjesë, apo janë prekur, nga një procedurë e falimentimit. Nenet 64, 65 dhe 66, të ligjit në fuqi, përcaktojnë renditjen, sipas së cilës kategorizohen dhe paguhet borxhet e personit, ndaj të cilit është iniciuar procedura e falimentimit.

Ligji në fuqi me dispozitat e veta, aktuale që i ka, nuk i ka paraparë detyrimet tatimore, prandaj ky ndryshim – plotësim, i ligjit 2003/4, është shumë me rëndësi për buxhetin e konsoliduar të Kosovës, sepse siguron se detyrimet tatimore, të kenë një përparësi ndaj detyrimeve të tjera, të përcaktuara deri tani me ligjin në fuqi. Qëllimi kryesor i këtij Projektligji, është që të sigurohemi që, detyrimet tatimore të kenë përparësi të caktuar, të paktën ndaj detyrimeve që mund të konsiderohen si detyrime tjera, siç janë:

- Kërkesat e pa siguruara duke përfshi kërkesat për paga, se nuk i nënshtrohen një prioriteti të lartë,
- Kërkesat e pronarëve të debitorëve, aksionarëve, anëtarëve themelor dhe pjesëmarrësve tjerë.

Ky ndryshim njëkohësisht do të thotë se edhe pas bërjes së ndryshimeve të propozuara, prapë me përparësi krahas detyrimeve tatimore do të mbeteshin kërkesat e precizuara nën a), kërkesa e siguruara, kërkesat prioritare të përfshira në pikat 1 – 8 të Ligjit, ku kryesisht kemi të bëjmë me shpenzimet lidhur me zbatimin e procedurës së falimentimit dhe kërkesës së kanë të bëjnë me të ardhurat personale, së paku me pagat për dy muajt e parë të atyre që janë mbet borxh.

Të nderuar deputetë!

Me këtë projektligj është paraparë të bëhet një ndryshim, respektivisht të shtohet një pikë e re, në nenin 65, të ligjit nr. 2003/4, pra të ligjit që po e bëjmë si ndryshim e cila pikë pastaj do të vendoset pas pikës c), të ligjit, si pikë e re d), me këtë përmbajtje:

Detyrimet tatimore të pashlyera, deri në momentin e hapjes së procedurës së falimentimit. Çka do të thotë kjo? Konkretisht për të mos u marrë kohë, organizatat që shkojnë në falimentim, duhet paraprakisht të kryejnë obligimet ndaj shtetit, obligimet tatimore, pastaj të kryejnë obligimet e tjera. Me përjashtim të obligimeve që kanë mbetur me shpenzimet e falimentimit që do të kryhen fillimisht dhe detyrimet për dy pagat e punëtorëve duhet të kryhet obligime ndaj shtetit, të gjitha që i kanë krijuar deri në momentin e falimentimit. Një praktikë të tillë nuk e kemi pasur deri tash dhe zakonisht organizatat që kanë shkuar në falimentim, i kanë ikur obligimit tatimor, ne dëshirojmë që ta plotësojmë këtë mungesë.

Në emër të Grupit Parlamentar, do të paraqitem, me këtë rast ju lus ta mbështetni këtë, sepse kam marrë si obligim nga grupi që ta themi dhe mendoj se është një procedurë shumë e rregullt.

Ju faleminderit shumë!

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e ka fjalën deputetja Nerxhivane Dauti

DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI – Ju faleminderit zoti kryesues, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, të nderuar të pranishëm ministra të cilët jeni prezent, Kemi të bëjmë me disa ndryshime, të cilat ministria i parasheh lidhur me ligjin për falimentimin, procedurën e falimentimit, dhe unë pajtohem me kolegun Brajshori, i cili bëri arsyetimin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, të cilin e kemi miratuar në legjislaturën e kaluar në këtë Kuvend. Ai është një ligj shumë i rëndësishëm për ekonominë e tregut, ekonominë e lirë, prandaj, ndryshimet janë të arsyeshme . Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e mbështes propozimin e kolegut, që të bëhen këto ndryshime. Edhe pse në pamje të parë duken se nuk janë të rëndësishme, sepse kemi të bëjmë me pak nene, por nenet janë fundamentale dhe janë thelbësore, prandaj në parim i mbështes këtu, në emër timin personal dhe në emër të grupit parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHIRI - Ju faleminderit,

Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. E ka fjalën deputeti Mazllom Kumnova.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA – Edhe Grupi Parlamentar i AAK-së, i ka shqyrtuar me kujdes, plotësimet dhe ndryshimet e propozuara në Ligjin për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim dhe me këtë rast ka konstatuar se hartuesi e ka kuptuar se disa dispozita të ligjit në fuqi, sidomos te detyrimet tatimore, kanë mbetur pezull dhe duhet të ndryshohen drejt prioritetëve.

Praktika e ka treguar se këto dispozita duhet të ndryshohen dhe plotësohen, sepse, detyrimeve tatimore duhet dhënë prioritet dhe jo të klasifikohen si dytësore. Grupi i AAK-së, i përkrah këto plotësime dhe ndryshime në drejtim të funksionimit dhe zbatimit të këtij ligji, që është në fuqi ,si dhe me anë të këtyre dy ndryshimeve mendojmë që edhe buxheti i Kosovës mund të plotësohet pak më tepër. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI - Ju faleminderit,
Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë reformiste ORA, e ka fjalën deputeti Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JAZARI – Ju faleminderit zotëri kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë.

Ligji për ndryshimin e ligjit, që e kemi sot para vetit, është një projektligj i cili e plotëson ligjin ekzistues edhe për më tepër e normon një aktivitet të cilin gjer më tani administrata tatimore e Kosovës, realisht e ka ndërmarrë pa ligj, sepse edhe deri më sot, në emër të inkasimit, të kërkesave të pashlyera administrata tatimore e Kosovës, ka ditur të shes pronat ndërmarrjeve, posaçërisht atyre shoqërore. Edhe është shumë interesante se, në cilën bazueshmëri ligjore e kanë bërë këtë akt, po sidoqoftë, ky veprim i i yni sot në Kuvend e krijon bazën ligjore që këto veprime tash e tutje, të mos bëhen në mënyrë arbitrare, por të bëhen me ligj dhe të normohen një herë e përgjithmonë.

Mendoj se nevoja ekziston, ato ndërmarrje të cilat falimentojnë duhet edhe detyrimet që i kanë ndaj shtetit t'i shlyejnë, përndryshe habitem se si, në atë versionin e parë të projektligjit që është miratua në Kuvend, kjo dispozitë nuk është paraparë atëherë. Pra, Grupi Parlamentar ORA, e përkrah ndryshimin e propozuar në ligj.

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHIRI - Ju faleminderit,
Në emër të grupit parlamentar 6+, ka fjalën deputetja Nuran Malta

DEPUTETJA NURAN MALTA – Teşekkür ederim , 6+ grupu adına ,6+ grubu adına sözde olan yasanın değişikliğini desteklemekteyiz bu yüzden 6+ grubu adına bu yasanın onaylanmasına yanayıs.Sağolun

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit,

Lus deputetët të përgatiten për votim, për miratimin në parim të Projektligjit për likuidimin dhe riorganizim e personave juridikë në falimentim,

Lus regjinë të përgatitet për votim,

Në sallë janë të pranishëm 63 deputetë, përgatitemi për votim, votojmë tani:

PËR.....56
KUNDËR.....1
ABSTENIM.....-

Konstatohet se projektligji është miratuar në parim dhe në bazë të rregullës 23. pika 6 dhe rregullës 35, pika 2, Kuvendi ngarkon këto komisione për punë të mëtejshme:

- Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe referues,
- Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion, Kornizë Kushtetuese dhe
- Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet në afat jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën 9 të rendit të ditës,

9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ri-destinimin e mjeteve të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Në pajtim me nenin 27. pika 3, Ligjit për menaxhimin e financave publike, dhe përgjegjësitë, Ministria për ekonomi dhe financa, i është drejtuar Kuvendit të Kosovës, me kërkesë për lejimin e transferit të mjeteve buxhetore të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Ftoj ministrin – zëvendësministrin Brajshori që ta arsyetojë propozimin.

ZËVENDËSMINISTRI BEHXHET BRAJSHORI – I nderuari zotëri kryesues, të nderuar ministra, kolegë deputetë,

Ne nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kemi marrë një kërkesë për disa transfere, dhe në bazë të ligjit mbi menaxhimin e financave publike, në vlerën deri në 20%, të ndikimeve negative, që merren nga projekti i caktuar, mund të bëhen me transferin e drejtpërdrejtë, nga Ministria, në vlerën prej 20 deri 40%, duhet të merret pëlqimi sërish, përkatësisht, Qeveria mund të bëjë transferin e ndikimeve, thuhet negative në këtë rast, kurse ato që kalojnë mbi 40% ,me pëlqimin e Qeverisë Kuvendi duhet ta aprovojë atë shumë mjetesh

Në këtë rast kemi të bëjmë me shumën mbi 40%, të ndikimi negativ, Ministria e Punës, na e ka paraqit këtë kërkesë, ne si Ministri e Financave kemi procedura në Kuvend, kërkojmë aprovimin tuaj. Besoj se materialin e keni marrë, sepse herën e kaluar ministri e ka thënë me gojë, kemi plotësuar kërkesën edhe me shkrim, Besoj se e keni lexuar, nëse ka nevojë ne i kemi këtu kategoritë e shpenzimeve, kemi kodet, kemi nënkodet, po që se ka nevojë do t'i themi edhe tash, nëse jo, nuk do të doja ta marrim kohën tuaj, ministri Selmanaj është këtu. Nëse ka nevojë për të arsyetua në detaje, do të thotë këto transfere, por ne si Ministri mendojmë se janë të arsyeshme dhe procedurat janë të këtilla, do të thotë, ministri, Qeveria, Kuvendi në këtë rast, mbi 40%, me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike duhet të bëjë aprovimin e transferit të këtyre mjeteve. Unë ju thërras që të aprovonit, sepse është gjithçka në pajtim me ligjin. Ju faleminderit shumë.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI - Ju faleminderit,
Për fjalë është lajmëruar deputetja Safete Hadërgjonaj,

DEPUTETJA SAFETE HADRËRGJONAJ - Ju faleminderit zotëri kryesues.

Ne kemi para vetes një kërkesë për transfer të mjeteve. Kjo është një shenjë për menaxhim të vjetër, planifikim jo të mirë të mjeteve me kohë, kur është bërë aprovimi i buxhetit dhe çka është shqetësuese është që, kërkesa na vjen në një moment kur veç kanë përfundua afati i zotimeve dhe i pagesës së mjeteve. Është e vërtetë që Ligji për menaxhimin e financave neni 27.3, e parasheh një mundësi të transferit të mjeteve brenda organizatës buxhetore dhe një miratim të tillë duhet kur kalon 40% nga shuma e përvetësimeve të ndikuara negativisht, miratimi duhet të merret nga Kuvendi. Mua më vjen mirë që për herë të parë ne për transfere të tilla po marrim vendim në Kuvend, por ajo çka mua më shqetëson është pse është bërë kjo kërkesë kaq vonë, kur ka pasur mundësi Ministria t'i identifikojë këto mjete dhe të krijojë një mundësi transferi më herët. Unë e kam një shkresë, por Ministria i ka bërë një kërkesë Ministrisë së Financave më datën 27 faktikisht me datën 30, Ministria e Financave më 30 nëntor ka pranuar një kërkesë të tillë, nga Ministria e Mirëqenies, edhe pse e bërë me vonesë megjithatë ka qenë brenda kufijve kur ka mundë të rregullohet kjo pa u mbyllë afatet e zotimeve dhe të pagesave, kurse e kemi edhe një shkresë që na ka ardhur këtu nga, që ju ka drejtua Kuvendit që është më datën, një datë pak e **fshime** me 7.12. që ju ka drejtua ministrin Shatri.

Problemi është që me udhëzimin administrativ 2006/12 data e mbylljes së transfereve dhe subvencioneve është data 8 dhjetor, kurse afati i mbylljes së pagesave është me datën 22 dhjetor, d.m.th. ditën e sotme në orën 12, Prandaj unë nuk e di se sa do të ketë mundësi që ky transfer i mjeteve të shkojë në destinacionin e caktuar, meqenëse janë përfundua afatet e zotimeve dhe të pagesës së mjeteve, ndoshta këto ka qenë mirë që zëvendësministri me na shpjegur. Nëse këta kanë shty afate të zotimeve dhe të mbylljes së pagesave dhe nuk janë vetëm këto afate të cilat janë paraqitur në udhëzimin administrativ në vitin 2006/12, meqenëse është fjala për rastet sociale, d.m.th. është një transfer i cili edhe sipas arsytimit cili na ka dhënë Ministria e mirëqenies është se është një minus i paraqitur në nga viti 2005, unë nuk jam që këto pagesa të pengohen, po vërtetë është mirë që të respektohen afatet, afatet të cilat janë paraqitur, meqenëse është fjala për asistencë sociale dhe pensione, unë do ti kisha dhënë një votë pro, që të bëhet një transfero i tillë, mirëpo problemi është që afatet kanë përfundua edhe të zotimeve edhe të pagesave. Prandaj është mirë me na sqarua pak zëvendësministri dhe unë nuk jam kundër që të bëhet një transfer i tillë po, të na kishte ardhur me kohë që, transferi i tillë vërtetë të bëhet brenda kufijve të cilët i lejojnë edhe udhëzimi edhe ligji, sepse në ligj nuk përcaktohet që këto bëhen në fund të vitit, po gjatë vitit buxhetor, ju faleminderit!

KRYESUESEI GAZMEND MUHAXHIRI - Ju faleminderit,
Ka e fjalën deputeti Nazim Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Ju faleminderit zotëri kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputet,
Kur na ka ardhur në Komision të Buxhetit kërkesa nga ana e Ministrisë për transferimin e këtyre mjeteve, t' jua them të drejtën kemi pasur informacione shumë të pakta edhe për rrethanat të cilat e kanë krijuar këtë tepëri në atë fund të caktuar, si ka ndodhur që ato mjete të mbesin të pashpenzuara? Ishte fjala për një fond për pagesat e lehonisë e që

realisht unë edhe sot nuk e di se si ka ndodhur ai suficit, por ana tjetër ishte që me këtë transfero të përfitonin pensionistët, një shtresë e cila është shumë e pa trajtuar mirë nga kjo shoqëri dhe të gjithë jemi të vetëdijshëm për vonesat e tyre në realizimin e atij pensioni prej 40 euro që ma mirë është të quhet ndihmë se sa pension dhe duke pasur parasysh këtë rrethanën e dytë sigurisht që e kam dhënë përkrahjen time të cilën edhe në grup parlamentar jemi dakorduar që të japim edhe në Kuvend . Pikërisht arsyeja pse kjo shkon në benefincion të pensionistëve na ka bërë që ta përkrahim përkundër të gjitha vonesave që i përmendi edhe parafolësja edhe për kundër të metave në planifikim të shpenzimeve buxhetore që në mënyrë sistematike kjo Qeveri po e manifeston. Ne do ta përkrahim këtë transfer.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI – Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, kurse le të përgatitet deputetja Selvije Halimi.

EMRUSH XHEMAJLI - Përsëritje z. kryesues. Edhe unë e mbështes transferin e propozuar nga ministri Selmanaj edhe e përgëzoj për insistimin e tij që të bëhet ky transfer shumë i nevojshëm edhe pse nuk është thënë është shumë i nënkuptuar për çfarë kategorie të shoqërisë bëhet fjalë këtu.Pra, e mbështes këtë vijë buxhetore, është dashur që të përshkruhet edhe aty në projektbuxhet. Këtë vijë projekt buxhetore e mbështes, ndërkaq vetë buxhetit nuk do t'ia jap pëlqimin nesër. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI – E ka fjalën deputetja Selvije Halimi.

SELVIOJE HALIMI – I nderuari kryesues, të nderuar deputetë.

Edhe kjo pikë e fundit të kësaj seance sot është një dëshmi në vazhden e shumë dëshmimeve se Kuvendi shndërrohet në servis të Qeverisë. Qeveria sot e shtyn Kuvendin t'i shkelë ligjet e veta, pikërisht për një kategori shumë të ndjeshme, kërkon transfer .Pra. Qeveria ka harruar se para një ore ka përfunduar afati i të gjitha pagesave në thesar nga të gjitha institucionet, ditën e sotme në orën 12,00 dhe tani servisi, ne kuvendarët jemi në shërbim të Qeverisë për t'i shkelur ligjet, krejt është në dakord, kur është kaq transparente shkelja kur e dimë se shumë shkelje që i di edhe Kuvendi edhe koalicioni dhe heshten dhe nuk bëhen publike, duke pasur për bazë një fakt që një shkelje e ligjeve duke u krekosur nga qeveritarët kërkohet që Kuvendi ta bëj sot për një kategori shumë të ndjeshme ,siç është rasti te pensionistët, Grupi Parlamentar i PDK-së do ta përkrahë, pse do ta përkrahë? Sepse po i shkelin ligjet në mënyrë shumë transparente edhe një dëshmi e keq menaxhimit të buxhetit edhe një dëshmi e keq planifikimit sikur edhe shumë dëshmi të tjera. Ju lutem qeveritarë bëni publike të gjitha dëshmitë e tjera të shkeljeve të ligjeve dhe keqpërdorimeve dhe planifikimeve që i bëni. Mos qitni në lajthitje kështu, le të mbetet kjo hera e fundit, sikur të mos ishte kategori sociale sigurisht se nuk do ta qitni në Kuvend, por do të manipuloni atje si dini ju, mirëpo keni arritur që Kuvendin ta shndërroni në servis të tuajin që t'ju thotë amin të gjithave, hallall ju qoftë, i qoftë për nder edhe koalicionit qeverisës që po hesht se çka është duke bërë kjo Qeveri, për hir të pensionistëve po e përsëris edhe njëherë PDK-ja e përkrah.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI – Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU – I nderuari kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë.

Nuk pata ndërmend të bisedoj, por meqë u ngritën teza se Kuvendi po shndërrohet në servis të Qeverisë, unë mendoj se është e kundërta. Qeveria në këtë rast po të ofron mundësi që të jetë servis yti dhe kjo është një kërkesë ligjore dhe respektim i një rregulle, është transparente dhe shumë e këndshme që lihet një transfer dhe bisedohet në nivel të Kuvendit me arsyetimin pse nuk ka ndodhur vija buxhetore nuk është realizuar dhe i dedikohet për transfer një sferë siç e thanë të gjithë një sferë shumë të ndjeshme, një kategori shumë të ndjeshme. Sa i përket pengesave ligjore apo më mirë pengesave në bazë të udhëzimit administrativ, është një dokument që e ka nxjerrë ministri i Financave dhe ne e pamë se Ministria e Financave e përkrah këtë transfer, prandaj në kompetencën e tij, sipas ligjit mbi menaxhimin e financave publike ajo mund të zvarritet edhe të vlejë deri në fund të dhjetorit apo edhe janarit. Këto përcaktohen për t'i lënë hapësirë thesarit në përmbylljen e librave dhe hapjen e librave të reja, prandaj unë nuk shoh ndonjë pengesë derisa Ministria e Financave e përkrah këtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI – Ju faleminderit. E ka fjalën deputetja Selviqe Halimi, replikë.

SELVIQE HALIMI –I nderuari ish- ministër ju keni të drejtë që e përkrahni këtë se shumë gjëra janë bërë gjatë kohës kur keni qeverisur ju dhe nuk ja keni pru fare Kuvendit, e dini ju shumë mirë. Unë thashë atë se jemi shndërruar në serevis të Qeverisë për t'ia pranuar shkeljen e ligjeve, sepse edhe shkelja e planifikimeve që aprovohen përmes buxhetit nga secili resor i Qeverisë është shkelje e ligjit. Plani është ligj për secilin resor, ju e dini shumë mirë këtë, andaj në emër të asaj se po bëjmë diçka për kategoritë sociale, siç është rasti për pensionistët, i ofrohet Kuvendi, shtyni afatet., Lejoni shkeljen, edhe rregullorja e Qeverisë 2006/12 është rregullore në fuqi dhe duhet të respektohet. Po bëjmë diçka në momentin e fundit për pensionistët, kjo nuk arsyetohet, pse nuk planifikohen me kohë, çka bëjnë me ata njerëz që nuk planifikojnë me kohë.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHIRI – Lus deputetët që të deklarohen për propozimin që mjetet e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale të ri-destinohen në transfero të kërkuar. Përgatitemi për votim, lus regjinë që të përgatitet dhe votojmë tani: Në sallë janë prezent 71 deputetë për aprovimin e ridestinimit të mjeteve kanë votuar 66 deputetë.

Deputetë të nderuar, ju njoftoj se seanca e nesërme për buxhetin është e caktuar në orën 10,00.

VAZHDIMI I SEANCËS PLENARE TË 23.12.2006

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Të nderuar deputetë, mirë se keni ardhur. Sot vazhdojmë me seancën që e kemi pas ndërprerë dhe e kemi shtyrë për sot. Me pikën e rendit të ditës

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2007

Atë ditë është zhvilluar debat i gjerë, prandaj sot vazhdojmë me punë

Urdhëroni Teuta Sahatqija . Është grup parlamentar

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA - Faleminderit z. kryetar. Duke pas parasysh që ky është vazhdimi i asaj seance më duhet t'i sqaroj disa gjëra

Së pari po më vjen mirë që opozita ishte ajo e cila e vetëdijesoi pozitën që për ligje kaq të rëndësishme do të duhet që pozita të jetë më serioze edhe t'i merr seriozisht çështjet edhe ligjet të cilat kanë rëndësi të veçantë. Prandaj e shoh si një sukses të madh të këtij Kuvendit edhe të opozitës.

E dyta, sa i përket Ligjit për financa publike dhe ndryshimi i Ligjit për financa publike e thotë që 8.33% e buxhet mund të shfrytëzohet me ligjin e parë ka qenë një herë me ndryshimin e ligjit ka qenë dy herë. Kjo do të thotë që buxheti nuk ka mundësi të bllokohet për shkak të opozitës dhe se ata arsimtarët edhe pensionistët nuk do të mbesin pa rroga, sepse pa ndihmën e Rykerit vetë ligji e lejon ministrinë edhe Qeverinë që ta vazhdojë buxhetin.

Prandaj ju lutem nuk qëndron aspak ajo teoria hipotetike që opozita e ka bllokuar buxhetin.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Prandaj çdo akuzat, akuzat e kryeministrit edhe të pozitës për bllokimin e buxhetit nuk qëndrojnë aspak. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës. Z. Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – z. kryetar i Kuvendi ashtu siç thatë ju edhe në fillim pjesa e debatit për këtë çështje ka përfundua. Na e kemi një rekomandim të Komisionit funksional që amendamentet të ndahen në disa grupe çështjen në të cilën e kemi pranuar herën e kaluar. Andaj ju lutem z. kryetar që sipas procedurës të filloni votimin për këtë çështje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit..

Ju njoftoj se në sallë janë 71 deputetë, që do të thotë se mund të punojmë.

Shkojmë me amendamentin e parë.

Votojmë tash.

Mirë, atëherë shkojmë me votim në dorë.
Kush është për? Ju faleminderit. Kundër 1 dhe një abstenim.
Konstatohet se amendamenti numër 1 kalon me shumicën e votave.

Amendamenti 2

Votojmë tash.

Me ngritje dore, Ju faleminderit, kush është kundër? Nuk ka,
Konsideroj se me shumicë votash është miratuar edhe amendamenti numër 2.

Amendamenti 3

Kush është për?, Ju faleminderit, Kundër a ka 1, abstenime nuk ka.
Konsideroj se me shumicë votash është miratuar edhe amendamenti numër 3.

Amendamenti 4

Kush është për? Ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenojnë nuk ka.
Konstatohet se edhe amendamenti numër 4 me shumicë votash është aprovuar.

Amendamenti 5

Kush është për. Faleminderit, kundër 1, abstenim 1
Konsideroj se amendamenti numër 5 me shumicë votash pranohet.

Amendamenti 6

Kush është për, ju faleminderit, kundër, Fadil ule dorën poshtë, se haroj, abstenim 1.
Konsideroj se me shumicë votash është aprovuar edhe amendamenti numër 6.

Amendamenti 7

Kush është për, ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.
Konsideroj se edhe amendamenti numër 7 me shumicë votash aprovohet.

Amendamenti 8

Kush është për, ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.
Konstatohet se edhe amendamenti numër 8 me shumicë votash është aprovuar.

Amendamenti 9

Kush është për? Ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.
Konstatohet se miratohet me shumicë votash.

Amendamenti 10

Konstatohet se miratohet me shumicë votash.

Amendamenti 11

Kush është për, ju faleminderit, kundër, nuk ka, abstenim 1.
Aprovohet amendamenti 11 me shumicë votash.

Amendamenti 12

Kush është për, ju faleminderit, kush është kundër, nuk ka, abstenim 1.

Konstatohet se amendamenti 12 me shumicë votash është aprovuar.

Amendamenti 13

Kush është për, ju faleminderit, kundër, nuk ka, abstenim 1.
Edhe amendamenti 13 me shumicë votash është aprovuar.

Amendamenti 14

Kush është për, ju faleminderit, kundër, nuk ka, abstenim 1.
Konstatohet se amendamenti 14 me shumicë votash është aprovuar.

Amendamenti 15

Kush është për, ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.
Konstatohet se edhe amendamenti 15 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 16

Kush është për, ju faleminderit, kundër 1, abstenim nuk ka.
Konstatohet se amendamenti 16 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 17

Kush është për, ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 2.
Konstatohet se amendamenti 17 me shumicë votash aprovohet.

Amendamenti 18

Kush është për? Ju faleminderit, kundër 1, abstenim nuk ka.
Amendamenti numër 18 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 19

Kush është për?, Faleminderit, kundër, abstenim 1.
Amendamenti numër 19 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 20

Kush është për? Ju faleminderit, kundër 1, abstenim 1.
Konstatohet se amendamenti numër 20 me shumicë votash aprovohet.

Amendamenti 21

Kush është për? Ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.
Konstatohet se amendamenti numër 21 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 22

Kush është për? Ju faleminderit, kundër 1, abstenim 1.
Konstatohet se amendamenti numër 22 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 23

Kush është për? Ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.
Amendamenti numër 23 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 24

Kush është për? Ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.
Me shumicë votash aprovohet edhe amendamenti numër 24.

Amendamenti 25

Kush është për? ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.
Amendamenti numër 25 miratohet me shumicë votash.

Amendamenti 26

Kush është për? Ju faleminderit, kundër 1, abstenim 1.
Amendamenti numër 26 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 27

Kush është për? Ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.
Amendamenti numër 27 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 28

Kush është për? Ju faleminderit, kundër 1, abstenim 1.
Amendamenti numër 28 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 29

Kush është për? Ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.
Edhe amendamenti numër 29 me shumicë votash miratohet.

Amendamenti 30

Kush është për? Ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1,
Konstatohet se amendamenti numër 30 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 31

Kush është për?, Ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 2.
Konstatohet se amendamenti numër 31 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 32

Kush është për? Ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.
Amendamenti 32 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 33

Kush është për? Ju faleminderit, kundër 1, abstenim 1.
Konsiderohet se amendamenti numër 33 me shumicë votash aprovohet.

Amendamenti 34

Kush është për? Ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.
Amendamenti numër 34 aprovohet me shumicë votash.

Amendamenti 35

Kush është për? Ju faleminderit, kundër nuk ka, abstenim 1.

Amendamenti numër 35 aprovohet me shumicë votash.

Naser kërkoni fjalën, urdhëroni.

Naser ta miratojmë ligjin në tërësi.

DEPUTETI NASER OSMANI – Faleminderit z. kryetar. Ne sa aprovuam amendamentet, amendamenti numër 8, neni 6.12. thotë kështu:

Të gjitha paratë publike që mblihen në agjencitë dhe në zyrat rregullatore të pavarura do të regjistrohen dhe llogariten si pjesë të Fondit të Konsoliduar të Kosovës, prandaj ne kemi obligim ta aprovojmë menjëherë edhe buxhetin e Agjencionit Antikorrupcion, ART-ës, Zyrës së Rregullatorit, të Energjisë elektrike dhe të prokurimit publik si organe që ia aprovon buxhetin ky Kuvend. Edhe të kisha lutë që në paketë me e aprovua në tërësi. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Lus regjinë le të përgatitet, kërkoi falje. Lus deputetët të votojmë për tekstin në tërësi bashkë me amendamentet që i aprovuam dhe propozimin e kryetarit të Komisionit për Buxhet.

Kush është për? Ju faleminderit, a ka kundër 7.
Konstatohet se Kuvendi me 65 vota për, 7 kundër

Për	65
Kundër.....	7

Aprovohet buxheti i Kosovës.

T' jua them edhe këtë se në momentin kur votuam i kishim 72 deputetë në sallë.

Ju faleminderit. Shihemi në seancat e ardhshme.

